MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT
MINISTARSTVO EKONOMIJE I OKOLISA
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AMMK

AGJENCIONI PER MBROJTJEN E MJEDISIT TE KOSOVES

KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY



Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018-2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT
MINISTARSTVO EKONOMIE I AMBIJENTA
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT AND AMBIENT

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TE KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018-2019

Prishtinë, Gusht 2020

Përmbajtja

Hyrje

1. Gjendja e mjedisit
1.1. Ajri
1.2. Uji
1.3. Toka/dheu
1.4. Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura
1.5. Mbeturinat
1.6. Zonat e rrezikuara mjedisore
1.7. Shëndeti publik
1.8. Shfrytëzimi i resurseve natyrore

2. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit
2.1. Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve mjedisore
2.2. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale
2.3. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të Ligjit
2.4. Leje-dhënia
2.5. Investimet në mbrojtjen e mjedisit

3. Të gjeturat dhe rekomandimet
3.1. Të gjeturat kryesore të raportit
3.2. Rekomandimet

4. Referencat

5. Lista e shkurtesave, figurave dhe tabelave

6. Shtojcat

Hyrje

Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit[1]. Sipas nenit 25, të këtij ligji, Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i paraqet Kuvendit, Raport për Gjendjen e Mjedisit.

Raporti duhet të përmbajë të dhëna për:

- gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm,
- ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës,
- gjendjen e mjediseve të rrezikuara,
- zbatimin e strategjisë së mjedisit dhe planit të veprimit,
- masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit,
- zhvillimin e institucioneve mjedisore dhe
- financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, është institucioni që harton këtë dokument.
Ky raport vjetor paraqet gjendjen e mjedisit për vitin 2018-2019, por edhe të dhëna të më hershme zënë vend të konsiderueshëm me qëllim krahasimi.
Për hartimin e raporti, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore që tani janë prezantuar në këtë raport.

Prezantimi i gjendjes për disa sektorë mjedisor është më pak i mbuluar si pasojë e mungesës të të dhënave, mungesës së monitorimit, bazës ligjore të pamjaftueshme apo dhe dobësive tjera institucionale e menaxhuese.
Cilësia e këtij raporti, deri në një masë është edhe reflektim i cilësisë së monitorimit që zbatohet në shkallë vendi dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor. Këto dy sisteme mjedisore ende janë në fazën e ngritjes dhe fuqizimit andaj ende ka mungesë të dhënave të plota dhe të besueshme.

Qëllimi kryesore këtij raporti është, informimi për gjendjen e mjedisit në Kosovë. Mirëpo të dhënat e tij janë një bazë e mirë që mund të shërbejnë edhe për hartimin e politikave adekuate mjedisore dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis, siç janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj.

[1] *Ligji Nr. 03/L-025*

FALËNDERIM



Të nderuar lexues!

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ka kënaqësinë qe të ndajë me ju Raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitet 2018 dhe 2019.

Ky Raport është përgatitur në kuadër të aktiviteteve për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore qe dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit dhe Plani i punës së AMMK për raportim të rregullt për gjendjen e mjedisit, ku edhe janë siguruar informacione të duhura për administratën, Qeverinë, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe publikun për zbatimin e politikave mjedisore.

Shpresojmë se ky Raport të ndihmojë organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit, dhe përcjelljen e zbatimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit.

Publiku i gjerë, mediat, OJQ-të mjedisore dhe dashamirët e mbrojtjes së mjedisit janë të mirëseardhur të shërbehen me këto të dhëna dhe mirëpresim bashkëpunimin e tyre sa i përket përmirësimit të gjendjes së mjedisit në përgjithësi.

Me këtë rast AMMK, shpreh falënderim të veçantë jo vetëm për stafin e AMMK-së, që ka punuar me përkushtim në përgatitjen e këtij raporti në kushte të jashtëzakonshme pandemie, por edhe të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare që kanë dhënë kontributin e tyre përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme.

U jemi mirënjohës edhe institucioneve dhe organizatave tjera ndërkombëtarë për mbrojtjen e mjedisit të cilët në çfarëdo forme kanë kontribuar qe AMMK të arrijë të publikoi këtë Raport në mënyrë profesionale.

Dr.sc. Ilir Morina, Drejtor Ekzekutiv i AMMK-*së*

1. Gjendja e mjedisit

1.1. Ajri

Historiku i monitorimi të cilësisë se ajrit në Kosovë

Monitorimit automatik i cilësisë së ajrit ka filluar nga fundi i vitit 2009 nga stacionet e vendosura në Prishtinë (Ndërtesa e ish Rilindjes dhe IHMK).
Gjatë vitit 2010, MMPH/DMM/IHMK ka bërë studimin preliminar për përcaktimin e lokacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit, të mbështetur nga KE – TAIEX.
Sipas studimit është propozuar **zonimi**, që Kosova do të ketë një **Aglomerat-AKS1** (duke përfshirë Prishtinën dhe Obiliqin), ndërsa pjesë tjera te vendit do të formojnë një **Zonë** monitoruese-**ZKS1** (Gjilani, Peja, Prizreni, Drenasi, Mitrovica dhe Hani i Elezit)[2] , (tab. nr.1 dhe 2).
Numri i stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është caktuar në bazë të kritereve te përcaktuara nga Direktiva 2008/50/EC. Sipas kësaj, rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë duhet të ketë 9 stacione të monitorimit automatik. Mirëpo, nga fundi i dhjetorit të vitit 2012 MMPH/AMMK nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me MZHE (financuar nga Banka Botërore) që edhe tri stacione te monitorimit automatik të cilësisë së ajrit te vendosur ne zonën e KEK-ut, (te financuar nga Banka Botërore), t'i kalon në pronësi MMPH/AMMK , kështu që aktualisht rrjeti nacional i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë ka 11 stacione fikse dhe një (1) stacion mobil për monitorimin automatik të cilësisë së ajrit. (tab.1 dhe 2 dhe fig.1).

Tabela 1. Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit-Aglomeracioni AKS 1

Aglomeracioni/Zona		Emërtimi i Stacionit Monitorues	Shenja e Stacionit (Kodi)	Lokacioni	Parametrat që maten	Tipi i zonës/aglomeracionit	Data e funksionalizimit
AGLOMERACIONI AKS 1	1	IHMK	KS0101	Prishtinë	PM10,PM2.5,SO_2, NO_x,O_3,CO	Sfondi urban	09.01.2009
	2	Rilindja	KS0102	Oborri i Rilindjes, Prishtinë	PM10,PM2.5,03,SO_2,CO,NO_2	Sfondi urban	06.05.2010
	3	Obiliq	KS0110	QMF	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x, O_3,CO	Sfondi urban	01.03.2013
	4	Dardhishtë	KS0111	Shkolla fillore	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x, O_3,CO	Sfondi urban/industrial	01.03.2013
	5	Palaj	KS0112	Kosova Mont	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x, O_3,CO	Sfondi industrial	01.03.2013

[2]*Sqarim: Stacioni monitorues në Brezovicë ishte aktivizuar më 03.09.2013, por i njëjti është jo funksional nga viti 2016.*

Tabela 2 . Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit-Zona ZKS 1

Aglomeracioni/ Zona		Emërtimi i stacionit monitorues	Shenja e stac./ Code	Lokacioni	Parametrat që maten	Tipi i zonës/aglomeracionit	Data e funksionalizimit
ZONA ZKS 1	1	Pejë	KS0305	Sh. F. "Lidhja e Prizrenit"	PM10, PM2.5	Sfondi urban	04.04.2012
	2	Prizren	KS0406	Kuvendi Komunal	PM10,PM2.5,SO_2,CO,NO_2,O_3	Sfondi urban	01.04.2012
	3	Hani i Elezit	KS0508	Shkolla fillore "Ilaz Hallaqi"	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi urb./ind.	05.04.2012
	4	Gjilan	KS0609	Kuvendi Komunal	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi urban	01.04.2012
	5	Drenas	KS0103	Shkolla fillore "Selami Hallaqi"	PM10,PM2.5. SO_2,NO_x,CO,O	Sfondi urban	05.04.2011
	6	Mitrovicë	KS0204	Stacioni i meteorologjisë	NO_2,CO,O_3, PM10, PM2.5	Sfondi urban	06.2013



Fig. 1: Vendndodhja e stacioneve për monitorim të cilësisë së ajrit

Sistemi online i të dhënave për cilësi të ajrit

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në fillim të viti 2018 ka lansuar sistemin për raportimin online të rezultateve për cilësi të ajrit që monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Finalizimi i softuerit është mbështetur nga Komisioni Europian si fazë testuese për 8 stacione monitoruese, përveç stacioneve në Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj, të cilat pritet që përmes projektve të JICA dhe MCC të kyçen në rrjetin online. Përmes sistemit online mundësohet informimi i saktë dhe në kohë reale i publikut për cilësinë e ajrit në disa komuna të Kosovës.
Softueri për raportimin e të dhënave për cilësinë e ajrit është kompatibil me Indeksin e Kualitetit te Ajrit në Evropë (AQI) dhe prezanton të dhënat e monitorimit të 5 indikatorëve kryesor në 8 stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit.
Në sistemin e të dhënave për cilësi të ajrit në kohë reale mundësohet çasje duke klikuar direkt në linkun e sistemit të të dhënave në ueb faqen e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (**http://ihmk-rks.com/t/?page=1,5**), përmes ueb faqes së Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (**http://ammk-rks.net/**) apo edhe përmes ueb aplikacionit **http://www.kosovo-airquality.com/secure/index2.html.**
Investimet në përmirësimin e sistemit për monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit do të vazhdojnë edhe me mbështetje shtesë nga Qeveria Amerikane përmes Programit të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) dhe nga Qeveria Japoneze përmes Agjencisë Ndërkombëtarë Japonez për Zhvillim (JICA). Në tabelën 3 janë prezanantua normat e cilësisë së ajrit sipas UA Nr.02/2011.

Tabela 3. Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare)µg/m³	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m³	30	Nuk parashihet
SO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore te maksimales 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m³	10	Nuk parashihet

PM10	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	120	Nuk parashihet

Cilësia e ajrit gjatë viteve 2018-2019

Vitet 2018 dhe 2019 karakterizohet me avancime të theksuara ne sigurimin e të dhënave nga stacionet monitoruese nën menaxhimin e IHMK. Gjatë vitit 2017 ishte arrit funksionalizimi i plotë i të gjitha stacioneve monitoruese (11 stacione monitoruese) dhe parametrave të paraparë për monitorim kontinual.
Edhe pse stacionet monitoruese në Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj, akoma nuk janë në sistemin online të dhënat paraqiten për çdo 24 orë dhe të njëjtat publikohen në web faqen e AMMK. Mbulesa kohore e rezultateve të monitorimit është e mirë përveç në raste të caktuara, ku për shkak të rrethanave objektive, mund të ketë ndonjë ndërprerje në funksionim të pajisjeve.
Sezoni vjeshtë-dimër çdo vit shënon ngritje të vlerave ndotëse në ajër. Edhe gjatë vitit 2018 pluhuri shënoi vlera shumë të larta në formë PM 10 dhe PM2.5 në disa lokalitete të vendit. Tejkalime të theksuara të Vlerave Maksimale të Lejuara (VML) kishte pothuaj në shumicën e stacioneve monitoruese dhe ate gjatë muajit janar, shkurt, tetor, nëntor dhe dhjetor 2018.
Në esencë, niveli i ndotjes se ajrit ne tërë territorin e Kosovës gjatë vitit 2018 nuk dallon nga niveli i ndotjes së ajrit ne vitet paraprake.

Kushtet meteorologjike në muajt e përmendur ishin të pavolitshme çka kanë ndikuar në akumulimin e ndotësve në ajër pa mundësi të shpërndarjes. Lëvizjet e masave ajrore ishin me intensitet të ulët (më pak se 2 m/sec), temperatura të ndryshueshme (2-15), shtypje atmosferike e lartë (1013-1016 hPa) dhe pa reshje. Më këto kushte atmosferike në pjesët urbane ku kemi trafik të dendur, lëvizje të automjeteve të vjetra, perdorimi i thëngjillit për ngrohje, dru e pelet etj. kanë ndikuar në rritjen e nivelit të ndotjes së ajrit.

Në fillim të muajit dhjetor 2018 kishim një situatë të rënduar, ku për 3 ditë rresht janë paraqitur tejkalime të përqendrimit të PM10. AMMK, ka ngritur shqetësimin për këtë situatë, duke informuar politikëbërsit në MMPH, qeverinë dhe Komunën e Prishtinës. Ligji për ajrin përkufizon obligimin e MMPH që të njoftojqeverinë, e cila me propozim të MMPH, harton Plan të Veprimit për masat, të cilat duhen ndërmarr për tejkalim të ndotjes së tillë.). Ky ishte ballafaqimi i parë për këtë vit me një situatë të tejkalimeve 3 ditë rresht të vlerave të PM10.

Tejkalime të vlerave të PM10 ishin paraqitur në Prishtinë-IHMK, Obiliq, Dardhishtë, Drenas dhe Gjilan. (Tab.4).

Tabela 4. Tejkalimet 3 ditore të pandërprerë të PM10, 2018

Data	Prishtinë-IHMK	Obiliq	Dardhishtë	Drenas	Gjilan
	PM10 µg/m³	PM10 µg/m³	PM10 µg/m³	PM10 µg/m3	PM10 µg/m3
01.12.2018	150	149	132	141	126
02.12.2018	153	186	161	129	173
03.12.2018	168	160	165	177	157

Për parametrar SO_2, CO dhe Ozon nuk janë regjistruar tejkalim të VML gjatë vitit 2018-2019. Vlera të rritura (të kohë pas kohshme) të përqëndrimit të NO_2 kishte në Aglomeracionin AKS1 në stacionet e monitorimit në IHMK, Rilindje, Obiliq, Dardhisht dhe Palaj.
Në vijim janë paraqitur të dhënat mujore mesatare për secilin parametër. Bazuar në Direktivat e BE për cilësi të ajrit dhe sipas Udhëzimit Administrativ Nr.15/2010 për kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese për cilësinë e ajrit, numrin dhe shpeshtinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave, Aglomeracioi AKS1 (Prishtina dhe Obiliqi) trajtohet ndaras nga Zona ZKS1 (Drenasi, Mitrovica, Gjilani, Hani i Elezit, Peja dhe Prizreni).

Cilësia e ajrit në AKS1 (Aglomeracioni i Prishtinës)

Aglomeracioni i Prishtinës përfshin 5 pika monitoruese të cilësisë së ajrit. Dy stacione monitoruese janë të vendosura në Prishtinë: njëra në oborrin e ish Rilindjes dhe tjetra në oborrin e IHMK. Tri stacione tjera monitoruese janë të vendosura në: Obiliq (QMF), në Dardhishtë (Shkolla Fillore) dhe një në Palaj (Objekt i Kosovomontit të KEK-ut).

Gjatë vitit 2018 kishte tejkalime të VML të **PM10** (40 µg/m³), në stacionin monitorues IHMK, Rilindje, Dardhishtë dhe Obiliq sa i përket mesatares vjetore. Tejkalimet ishin të theksuara gjatë muajit janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor te vitit 2018 (Tab.5). Gjatë vitit 2019, muajt me të ndotur ishin janari, shkurti, marsi dhe dhjetori. Nëse bëhet krahasimi për periudhat e njëjta kohore për dy vitet, në vitin 2019 ka një zvogëlim të ndotjes me PM10.

Tabela 5. Vlerat mesatare mujore te PM10, nëpër muajt të 2018/2019 në AKS1

Muajt	Vitet	IHMK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhisht
Janar	2018	96.6	79.6	40	106.9	91
	2019	57.8	41.1	34.9	75.9	61.4
Shkurt	2018	37.1	43.1	17	42.5	37
	2019	33.2	24.6	20.1	43.6	33.9
Mars	2018	29.7	36.3	14	35.8	30
	2019	24	18.4	15	28.8	22.4
Prill	2018	37.6	41.1	19	41.1	31.3
	2019	16.7	13.1	11.7	19.8	28.3
Maj	2018	20.4	26.5	11.9	23.4	16

	2019	8.2	8	4.3	8.5	4.9
Qershor	2018	19.6	22.9	10.5	20.7	8.7
	2019	10.9	8.7	6.6	9.5	6.4
Korrik	2018	23	22.9	*	19.7	17
	2019	9.5	7.5	6.4	8.9	6.3
Gusht	2018	25	23.7	*	21.2	24.2
	2019	10.2	7.9	7.3	9.8	10.1
Shtator	2018	26.9	24.2	16.9	28.2	33.6
	2019	11	8.9	7.7	11.3	11.6
Tetor	2018	39	35.6	22.2	40	39
	2019	22.6	15.6	23.8	26.9	31.1
Nentor	2018	51.1	35	27.8	53.3	53
	2019	16.9	14.3	12.8	24.4	18.8
Dhjetor	2018	78.4	53.3	44.9	85.3	70.6
	2019	27	27.5	18.2	34.6	34.2
Mesataret	2018	40.36	37.01	22.42	43.17	37.61
	2019	20.6	16.3	14.1	25.1	22.4

Për paramtrin **PM2.5** janë regjistruar tejkalime gjatë muajve janar, shkurt, tetor, nëntor dhe dhjetor për vitet 2018/2020. Përveç në Palaj, ku kishte tejkalime të lehta, në stacionet tjera (IHMK, Rilindje, Obiliq dhe Dardhishtë) kishte tejkalime të theksuara të VML (25 μg/m^3), (Tab.6).

Tabela 6. Vlerat mesatare mujore te PM2.5 per vitet 2018/2019 në AKS1

Muajt	**Vitet**	**IHMK**	**Rilindje**	**Palaj**	**Obiliq**	**Dardhisht**
Janar	2018	87	69.2	38.9	97.8	87.5
	2019	57.8	41.1	34.9	75.9	61.4
Shkurt	2018	29.8	33.7	13.1	37.2	32.9
	2019	33.2	24.6	20.1	43.6	33.9
Mars	2018	22	25	9.1	28.1	23.8
	2019	24	18.4	15	28.8	22.4
Prill	2018	17.5	19.9	7.8	17.3	13
	2019	16.7	13.1	11.7	19.8	28.3
Maj	2018	11.3	12.3	5.1	10.4	8.6
	2019	8.2	8	4.3	8.5	4.9
Qershor	2018	11.7	12.7	5.1	9.2	3.7
	2019	10.9	8.7	6.6	9.5	6.4
Korrik	2018	14.7	14.1	*	10.7	9
	2019	9.5	7.5	6.4	8.9	6.3
Gusht	2018	15	14.1	*	11.5	10.6
	2019	10.2	7.9	7.3	9.8	10.1
Shtator	2018	15.6	14.2	7.8	16.5	14.1
	2019	11	8.9	7.7	11.3	11.6
Tetor	2018	25.5	23.1	13.5	26.5	22.4
	2019	22.6	15.6	23.8	26.9	31.1
Nentor	2018	37.7	26	19.9	43.3	37.6
	2019	16.9	14.3	12.8	24.4	18.8
Dhjetor	2018	63.9	45.4	34	75.7	60.8
	2019	27	27.5	18.2	34.6	34.2
Mesataret	2018	29.30	25.80	15.43	32.01	27
	2019	20.6	16.3	14.1	25.1	22.4

Ozoni në zonën e AKS1 nuk kishte tejkalime të VML (120 μg/m³). Në Obiliq, Dardhisht dhe Palaj, kishte vlera më të larta krahasuar me vlerat e ozonit në stacionet tjera monitoruese për vitin 2018. Gjatë vitit 2019 vlerat e ozonit janë vlerësuar me të ulëta në krahasim me periudhat e njëjta kohore me vitin paraprak, (Tab. 7).

Tabela 7.Vlerat mesatare mujore te Ozoni gjatë viteve 2018/2019 në AKS1

Muajt	Vitet	IHMK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhisht
Janar	2018	19.3	3.14	51.8	24.7	53.1
	2019	1.4	2.1	*	2	3.3
Shkurt	2018	33.2	3	74.9	40.4	67.8
	2019	1.4	1.8	*	1.2	3.9
Mars	2018	4	52.2	77.8	52.2	75.9
	2019	1.5	1.6	*	0.8	3.8
Prill	2018	36	12.3	51.5	49.8	66.8
	2019	1.6	1.6	0	0.7	0.2
Maj	2018	26.3	27.7	44.6	60.3	70.4
	2019	1.6	1	0.3	0.3	0.1
Qershor	2018	*	52.4	47.8	113.8	66.1
	2019	0.5	0.3	0.2	0.4	1
Korrik	2018	70.2	*	*	77.5	64.2
	2019	0.8	0.5	0.4	1.9	1.7
Gusht	2018	*	57.1	*	69.8	64.9
	2019	0.7	0.7	0.2	2.8	2.7
Shtator	2018	*	62	58.9	71.2	67.1
	2019	1.1	0.9	0.1	0.4	3.7
Tetor	2018	*	45.2	47.5	58.2	55.9
	2019	1.6	1	0.2	0.6	4.6
Nentor	2018	37.7	26	19.9	43.3	37.6
	2019	2	1.4	0.1	0.5	5.9
Dhjetor	2018	63.9	45.4	34	75.7	60.8
	2019	2.4	3.2	0.3	1.9	6.2
Mesataret	2018	36.32	35.13	50.87	61.40	62.55
	2019	1.3	1.3	0.2	1.1	3.1

Për parametrin **NO_2** janë regjistruar disa tejkalimetë VML vjetore (40 μg/m³). Në stacionin monitorues në Rilindje, IHMK, Obiliq dhe Dardhisht kishte tejkalime në disa raste për të dy vitet. Vlerat më të larta ishin gjatë muajve janar, shkurt, mars, tetor, nëntor dhe dhjetor, (Tab. 8).

Tabela 8. Vlerat mesatare mujore te NO_2 gjatë viteve 2018/2019 në AKS1

Muajt	Vitet	IHMK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhisht
Janar	2018	26.1	51.7	20.8	35.2	42.9
	2019	53	65.2	37	59	68.5
Shkurt	2018	18.8	52.6	8.2	19.5	20.1
	2019	39.7	41.8	18.2	32.3	27.3
Mars	2018	20.8	65.8	5.4	16.3	16.1
	2019	43.5	47.8	14.3	24.4	27.4
Prill	2018	54.5	30.6	2.7	12.8	13.7
	2019	34.6	39.7	11.2	18.4	12

Maj	2018	33.1	46.4	2.2	12.8	9.5
	2019	23.9	31.8	5.3	10.7	13.8
Qershor	2018	32.2	27.2	4.4	10.3	12.3
	2019	22.6	32.7	6.4	8.3	10.3
Korrik	2018	26	*	*	11.1	8.1
	2019	25.9	43.2	7.2	14.5	11.2
Gusht	2018	*	30.5	*	16.1	13.6
	2019	31	*	8.2	21.1	13.3
Shtator	2018	31.2	31.9	5.9	12.8	9.5
	2019	26.3	*	7.3	84	12.9
Tetor	2018	43.5	34.5	8.4	15.2	11.2
	2019	36.7	56.7	12.3	28.1	18.4
Nentor	2018	51.3	35.1	15.7	19	15.7
	2019	18.6	40.4	9.8	21.8	15.2
Dhjetor	2018	59.8	49.8	32.9	33.7	35.6
	2019	23.7	39.9	12.6	21.9	17.3
Mesataret	2018	36.11	41.44	10.66	17.9	17.35
	2019	31.6	43.9	12.4	28.7	20.6

Për parametrin **SO_2** gjatë vitit 2018/2019 nuk kishte tejkalime të VML (120 μg/m^3) në asnjërin nga stacionet monitoruese. Megjithatë në Obiliq kishte vlera më të larta krahasuar me stacionet tjera monitoruese në AKS1, (Tab. 9)

Tabela 9: Vlerat mesatare mujore te SO_2 gjatë viteve 2018/2019 në AKS1

Muajt	**Vitet**	**IHMK**	**Rilindje**	**Palaj**	**Obiliq**	**Dardhisht**
Janar	2018	4.1	8.6	31.1	82.9	*
	2019	6.2	18.2	19.7	2.4	*
Shkurt	2018	3.9	10.7	26.4	79.3	*
	2019	3.1	19.6	12.9	10.6	*
Mars	2018	3	13.6	5.6	63.8	*
	2019	3.2	28.1	0	7	9.4
Prill	2018	2	5.5	2.9	50.3	*
	2019	2.7	31.4	6.8	6.8	0
Maj	2018	1.4	20.8	2.4	37.3	*
	2019	3.7	4.6	9.6	6.6	4.9
Qershor	2018	0.95	35	7	48.8	*
	2019	6.6	8.6	10.1	3.2	10.2
Korrik	2018	38.2	53.8	*	53.7	*
	2019	8	12.1	10.3	26	21.1
Gusht	2018	41.9	50.1	*	59.5	*
	2019	7.4	10.7	10.6	35.2	31.3
Shtator	2018	42.2	68.2	11.5	64.5	*
	2019	8.1	9.5	9.8	3.8	9.4
Tetor	2018	43.3	65.6	12.4	70.3	*
	2019	11.2	11	9.5	7.5	16.5
Nentor	2018	44.2	77	21.6	82.5	*
	2019	6.8	10.4	5.1	5.9	10.3
Dhjetor	2018	26.7	12.4	37.2	73	*
	2019	11.1	12.4	5.3	8.7	13.5

Mesataret	2018	20.98	35.10	15.81	63.82	*
	2019	6.5	14.7	9.9	10.3	14.1

Parameti **CO** nuk kishte asnjë tejkalim të VML (10 mg/m^3) në asnjërin nga stacionet për monitorim të cilësisë së ajrit në AKS1, (Tab. 10).

Tabela 10. Vlerat mesatare mujore te CO gjatë viteve 2018/2019 në AKS1

Muajt	Vitet	IHMK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhisht
Janar	2018	4.2	1.4	*	1.4	3.3
	2019	1.4	2.1	*	2	3.3
Shkurt	2018	3.8	2.8	*	1	3.9
	2019	1.4	1.8	*	1.2	3.9
Mars	2018	1	3.4	*	0.98	2.3
	2019	1.5	1.6	*	0.8	3.8
Prill	2018	6.5	3.3	*	0.68	0.8
	2019	1.6	1.6	0	0.7	0.2
Maj	2018	2.2	3.1	*	0.7	1
	2019	1.3	1	0.3	0.3	0.1
Qershor	2018	2	1.4	*	0.49	0.54
	2019	0.5	0.3	0.2	0.4	1
Korrik	2018	1.4	1	*	0.6	1
	2019	0.8	0.5	0.4	1.9	1.7
Gusht	2018	1.5	2	*	0.7	1.5
	2019	0.7	0.7	0.2	2.8	2.7
Shtator	2018	1.3	1.3	1.8	0.8	2.3
	2019	1.1	0.9	0.1	0.4	3.7
Tetor	2018	1.1	2.4	1.9	*	3.1
	2019	1.6	1	0.2	0.6	4.6
Nentor	2018	1.8	3.8	*	1.4	4.9
	2019	2	1.4	0.1	0.5	5.9
Dhjetor	2018	2.6	5.5	*	2	4.1
	2019	2.4	3.2	0.3	1.9	6.2
Mesataret	2018	2.45	2.61	1.85	0.97	2.39
	2019	1.3	1.3	0.2	1.1	3.1

Ditët me tejkalimet[3] për PM10 gjatë viteve 2018/2019, janë prezantuar në tabelën nr.11. Nga tabela shihet se gjatë vitit 2018 në të gjitha stacionet janë regjistruar tejkalime, ndërsa në vitin 2019, tejkalime janë regjistruar në të gjitha stacionet matëse më përjashtim të stacioneve Rilindja dhe Palaj.

Tabela 11: Ditët me tejkalime për PM10/2018/2019

Muajt	Vitet	IHMK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhisht
Janar	2018	21	21	11	23	13
	2019	15	8	7	22	13

[3] *Norma e lejuar për PM10, sipas UA Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit, është deri në 35 ditë tejkalime gjatë një viti kalendarik*

Shkurt	2018	5	8	1	6	7
	2019	11	4	4	12	9
Mars	2018	3	4	0	3	4
	2019	7	1	1	10	6
Prill	2018	4	2	0	8	0
	2019	3	2	2	8	8
Maj	2018	0	0	22	0	0
	2019	0	0	0	0	0
Qershor	2018	0	0	0	0	0
	2019	0	0	0	0	0
Korrik	2018	0	0	0	0	0
	2019	0	0	0	0	0
Gusht	2018	0	0	0	0	0
	2019	0	0	0	0	0
Shtator	2018	1	1	0	1	1
	2019	0	0	0	0	0
Tetor	2018	7	2	0	6	7
	2019	8	3	5	10	8
Nentor	2018	13	5	4	17	14
	2019	1	0	0	0	0
Dhjetor	2018	21	14	6	22	18
	2019	6	11	1	10	9
Mesatarja	2018	75	57	44	86	64
	2019	51	29	20	72	53

Cilësia e ajrit në Zonën ZKSI

Zona ZKS1 përfshin territorin e monitoruar për cilësinë e ajrit në këto qendra: Drenasi, Mitrovica, Peja, Prizreni, Hani i Elezit, dhe Gjilani. Stacioni për cilësi të ajrit në Brezovicë ka rolin e stacionit indikativ krahasues. Gjatë vitit 2018 vlerat me te larta të PM10 janë vlerësuar të jenë në Drenas, Mitrovicë, Han të Elezit dhe Gjilan. Në vitin 2019, vlerat me te larta të PM10 janë vlerësuar të jenë në Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan. (Tab.12).

Tabela 12. Vlerat mesatare mujore te PM10 gjatë viteve 2018/2019 në ZKS1

Muajt	***Vitet***	**Drenas**	**Mitrovicë**	**Pejë**	**Prizren**	**Hani i Elezit**	**Gjilan**	**Brezovicë**
Janar	2018	64.6	78.8	*	59.8	72.7	129.4	*
	2019	71	66.3	76.9	68	46.5	87.5	*
Shkurt	2018	34.6	46.2	*	33.5	66.6	*85.2*	*
	2019	12.7	36.7	48.5	42	40.1	*79.8*	*
Mars	2018	31.8	46.5	*	29.2	98.8	83.7	*
	2019	16.9	35.2	35.4	28.8	44.6	35.4	*
Prill	2018	43.3	48.8	22.3	22.3	121	65.7	*
	2019	19.3	31.8	16.5	26.1	28.4	16.1	*
Maj	2018	25.5	22.4	14.1	18.6	66.6	42.8	*
	2019	9	17.8	9.6	13.3	13.1	7.5	*
Qershor	2018	21.3	19	18.1	4.4	74.5	37.1	*
	2019	15.4	21.5	11	13.8	8.9	5.3	*

Korrik	2018	22	23.8	24.5	18.5	48	41.9	*
	2019	15.1	16.6	10.7	15.3	7.6	4.4	*
Gusht	2018	29.1	26.3	*16.3*	18.8	50.6	*36.1*	*
	2019	18.1	19.1	7.8	16.9	7.7	*4.2*	*
Shtator	2018	33.8	26.4	*	13.4	59	40.3	*
	2019	15.8	18.3	0	17.3	11.9	4.3	*
Tetor	2018	48.1	37.9	*	*	56.3	56.5	*
	2019	25.1	33.4	*	30.1	29.7	28.2	*
Nentor	2018	63.1	47.2	*	*	98	8	*
	2019	22.9	38.4	54.3	40.5	31.3	45.2	2.5
Dhjetor	2018	69.4	58.6	80.1	70.3	49	108.1	*
	2019	43.6	45.5	58.7	58.5	35	*49.5*	*1.8*
Mesatarja	2018	40.55	40.15	29.23	28.88	71.71	*61.23*	*
	2019	*23.7*	31.7	32.9	*30.8*	*25.4*	*30.6*	*2.1*

Për parametrin **PM2.5** janë regjistruar tejkalime të VML (25 μg/m^3) në të gjitha stacionet monitoruese me përjashtim të stacionit në Brezovicë. Të theksuara ishin tejkalimet në sezonin pranverë-vjeshtë-dimër, (Tab. 13).

Tabela 13. Vlerat mesatare mujore te PM2.5 gjatë viteve 2018/2019 në ZKS1

Muajt	Vitet	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Hani i Elezit	Gjilan	Brezovicë
Janar	2018	54.6	55.6	*	41.2	53.9	29.8	
	2019	59.8	58.2	71.6	62.2	40.4	78.1	*
Shkurt	2018	26.3	33.8	*	25.8	31	21.2	
	2019	12.2	26.8	38.3	31.8	25.2	51.3	*
Mars	2018	17.5	31.2	*	23.5	26.3	17	
	2019	11.7	22.1	25.6	17.5	21.1	26.1	*
Prill	2018	14.5	18.5	14.6	12.2	32	5.6	
	2019	12.3	21.5	12.3	16.3	14.9	11.6	*
Maj	2018	12.2	10.2	6.4	8.2	36.3	20.2	
	2019	6.2	11.8	7.2	8.1	7.5	5.3	*
Qershor	2018	10.3	12	10.7	4.1	13.9	15.5	
	2019	9	14	7.5	7.9	6.2	4	*
Korrik	2018	11.3	17	*	*	11.2	*	
	2019	8.6	10.8	7.5	8.9	5.4	3.3	*
Gusht	2018	14	17.3	9.4	11	14.2	18.5	
	2019	9.7	12	5.7	9.5	5.5	3.4	*
Shtator	2018	15.7	15.5	*	8.9	17.5	19.7	
	2019	9.8	11.9	*	10.1	7.6	3.8	*
Tetor	2018	25.5	26.5	*	*	15.3	33.6	
	2019	18.7	22	*	19.6	17.9	22.3	*
Nentor	2018	39.7	37.2	*	*	37.4	46.1	
	2019	17.8	28.3	47.9	30.5	20.3	26.1	2.1
Dhjetor	2018	51.4	48.1	68.7	60.4	36	82.8	
	2019	33.9	36.9	47.2	47.5	26.9	40	1.8

Mesatarja	2018	24.41	26.9	21.96	21.7	27.08	28.18	
	2019	17.4	23.1	27.1	22.5	16.5	22.9	1.9

Ozoni paraqitet në vlera normale dhe nuk kishte tejkalime të VML (120 µg/m^3), në asnjë nga stacionet për vitet 2018/2019, (Tab. 14).

Tabela 14. Vlerat mesatare mujore te Ozonit gjatë viteve 2018/2019 në ZKS1

Muajt	Vitet	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Hani i Elezit	Gjilan	Brezovicë
Janar	2018	*	44	*	38.2	14.6	10.4	
	2019	*	53.1	*	35.7	37.8	23.8	*
Shkurt	2018	*	49	*	38	66.3	14.2	
	2019	*	52.8	*	54.7	44.6	26.1	*
Mars	2018	*	54	*	26	63	18	
	2019	*	58.9	*	71.7	48.8	40.3	*
Prill	2018	*	36.6	*	72	52.2	24	
	2019	*	52.6	*	72.1	51.2	53.2	*
Maj	2018	*	30.9	*	72.1	67.7	21.2	
	2019	*	41.1	*	54	43.6	53	*
Qershor	2018	*	32.6	*	87.3	68.5	89.3	
	2019	*	33.1	*	60.6	31.4	60.7	*
Korrik	2018	*	35.3	*	70.2	50	9	
	2019	*	35.4	*	67.4	38.2	69.6	*
Gusht	2018	*	42.6	*	79	50.3	8.7	
	2019	*	34.6	*	75.9	46.5	68	*
Shtator	2018	*	43.7	*	80	39.4	8.8	
	2019	*	32.9	*	59.2	50.8	46.7	*
Tetor	2018	*	30.9	*	60.1	37.7	13.2	
	2019	28.7	24	25.7	39	41.4	29.2	41.6
Nentor	2018	*	23.8	*	34.2	21.9	5.3	
	2019	39.1	17	11	31.1	21.3	29.9	73.9
Dhjetor	2018	*	39.4	*	30.3	26.5	11	
	2019	32	23.6	14.6	29	23.4	30.8	74
Mesatarja	2018	*	38.56	*	57.28	46.50	19.42	
	2019	33.2	38.2	17.1	54.2	39.9	44.2	63.1

Për **NO_2** janë regjistruar disa vlera me tejkalime kontinuale të VML (40 µg/m^3) në Han të Elezit dhe më pak tejkalime në Gjilan e Prizren, (Tab. 15).

Tabela 15. Vlerat mesatare mujore te NO_2 gjatë viteve 2018/2019 në ZKS1

Muajt	Vitet	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Hani I Elezit	Gjilan	Brezovicë
Janar	2018	24.2	18.6	*	31.9	67.4	45.1	
	2019	39.3	31.1	*	29.1	38	67.7	*
Shkurt	2018	14.8	13.5	*	25.9	45.6	36.8	
	2019	21.3	14.5	*	17.9	55.2	51.2	*
Mars	2018	12.5	12.9	*	52.6	46.2	43	

	2019	16.7	15.9	*	9	61.3	35.2	*
Prill	2018	10.5	7.8	*	16.5	56.3	33.8	
	2019	16.6	13	*	9.6	57.4	24.3	*
Maj	2018	8.8	3.1	*	35.2	49.2	28.8	
	2019	11.1	9.4	*	12.8	42.6	17.9	*
Qershor	2018	6.7	16.8	*	13.6	63.6	28.3	
	2019	10.8	9.8	*	9.3	22.4	16	*
Korrik	2018	5	2	*	16.5	*	33.3	
	2019	12.7	16	*	7.2	26.3	19.2	*
Gusht	2018	8.4	5.6	*	18.6	58.2	32.6	
	2019	16.1	18.7	*	10.1	34.8	23.4	*
Shtator	2018	10.2	5	*	14.9	66.5	33.8	
	2019	13.4	15.5	*	6.8	36.3	20.8	*
Tetor	2018	13.4	7.5	*	20.1	69.3	33.8	
	2019	16.2	17.2	15.7	15.4	40.5	28.6	2.3
Nentor	2018	14.2	6.1	*	25.9	37.6	29.6	
	2019	14.5	13.9	10.4	26.5		22.2	1.2
Dhjetor	2018	23.6	16.4	*	26.3	54.2	58.8	
	2019	17.5	15.6	13.4	15.6		21.3	1.4
Mesatarja	2018	12.69	9.60	*	24.83	55.82	36.47	
	2019	17.1	15.8	13.1	14.1	36.4	28.9	1.6

Për parametrin **SO_2** nuk janë regjistruar tejkalime të VML (125 µg/m^3) në stacionet monitorues në kuadër të ZKS1. Një rast i vetëm është regjistruar në stacionin e Prizrenit në muajn janar, 2018. Në Mitrovicë kishte të regjistruara vlera më të rritura gjatë sezonit të verës, (Tab.16).

Tabela 16. Vlerat mesatare mujore te SO_2 gjatë viteve 2018/2019 në ZKS1

Muajt	Vitet	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Hani i Elezit	Gjilan	Brezovicë
Janar	2018	119.4	29.3	*	138.8	10.4	10.4	
	2019	12.3	3.2	*	*	4	9.8	*
Shkurt	2018	115.2	31.4	*	36.5	18.3	6.5	
	2019	6.8	3.9	*	6.8	3.5	9.1	*
Mars	2018	94.3	34	*	36.6	60.2	13.6	
	2019	6.9	3.5	0	0	3.5	10.4	*
Prill	2018	41.9	36.6	*	20.1	51.2	15.7	
	2019	17.5	6.1	0	22.1	5.1	10.9	*
Maj	2018	12.4	10.2	*	8.2	45.2	22.7	
	2019	33.3	11.1	0	8	7.5	11	*
Qershor	2018	4.8	9.2	*	38.2	74	25.3	
	2019	33	15.5	0	12.8	9.1	11	*
Korrik	2018	2.3	79.6	*	*	8.7	27.6	
	2019	32.3	15.7	0	15.5	13.5	14.3	*
Gusht	2018	2.6	83.9	*	*	10.2	28.8	
	2019	30.8	16.7	0	7.6	15	17.5	*

Shtator	2018	5.7	83.1	*	16.7	13.9	31.9	
	2019	28.6	16.8	0	11.7	17.3	18.5	*
Tetor	2018	5.6	80.4	*	22.7	48.9	31.9	
	2019	15.3	12.5	1.2	10.1	13	25.5	0.8
Nentor	2018	9.4	78.9	*	16.6	15.7	34.3	
	2019	2.2	28.9	1.9	5.9	1.4	4.6	1.3
Dhjetor	2018	15.6	49.2	*	*	2.8	25	
	2019	5.5	46.8	1.5	5.1	0.8	2.2	1.3
Mesatarja	2018	35.76	50.48	*	37.15	29.95	22.80	
	2019	18.7	15.1	1.5	10.5	7.8	12.0	1.1

Për parametrin **CO** nuk janë regjistruar tejkalime të VML (10 mg/m^3) në asnjë nga stacionet monitoruese në ZKS1 (Tab. 17).

Tabela 17. Vlerat mesatare mujore te CO gjatë viteve 2018/2019 në ZKS1

Muajt	**Vitet**	**Drenas**	**Mitrovicë**	**Pejë**	**Prizren**	**Hani i Elezit**	**Gjilan**	**Brezovicë**
Janar	2018	*	*	*	*	1.9	2.3	*
	2019	1	1.5	*	1.5	0.9	1.8	1.5
Shkurt	2018	*	*	*	*	0.2	2.5	*
	2019	0.5	0.8	*	0.9	0.8		*
Mars	2018	*	*	*	*	2.9	2.2	*
	2019	0.8	0.7	*	1.1	1.2	0.8	0.5
Prill	2018	0.5	0.4	*	*	4.1	*	*
	2019	0.7	0.5	*	1.4	0.9		*
Maj	2018	0.49	0.8	*	*	3.2	*	*
	2019	1	0.2	*	0.2	1.1	0.6	0.8
Qershor	2018	0.7	1	*	1.8	2.1	1.8	*
	2019	1.2	0.2	*	0.3	0.7		*
Korrik	2018	0.9	1.4	*	0.5	*	*	*
	2019	1	0.3	*	0.3	1.3	1	0.7
Gusht	2018	0.89	1.7	*	0.5	*	*	*
	2019	0.4	0.1	*	0.9	0.4		*
Shtator	2018	0.76	2	*	0.4	2.9	1.9	*
	2019	0.6	0.1	*	0.9	0.3	0.4	0.4
Tetor	2018	5.6	2.3	*	0.6	2.7	2.9	*
	2019	0.8	0.1	0.7	1	0.2		0.1
Nentor	2018	1.1	2.8	*	1.4	2	2.1	*
	2019	0.5	0.4	0.6	o.6	0.3	0.5	0.80.4
Dhjetor	2018	1.6	2.7	*	1.8	2.6	3.1	*
	2019	0.8	0.6	0.9	0.9	0.4		0.6
Mesatarja	2018	1.39	1.67	*	1	2.46	2.35	*
	2019	0.7	0.4	0.7	0.8	0.7	0.8	0.3

Ditët me tejkalimet për PM10 gjatë viteve 2018/2019 janë prezantuar në tabelën nr.18, nga shihet se gjatë vitit 2018, janë regjistruar tejkalime vetëm në stacionet e Pejës dhe Prizrenit, ndërsa gjatë vitit 2019, tejkalimet janë regjistruar në të gjitha stacionet me përjashtim të stacionit në Drenas.

Tab.18: Ditët me tejkalime për PM10 për vitet 2018 dhe 2019 në ZKS1

Muajt	Vitet	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Hani i Elezit	Gjilan	Brezovicë
Janar	2018	14	17	0	8	10	20	
	2019	14	17	22	21	13	27	*
Shkurt	2018	4	11	0	3	8	13	
	2019	4	8	12	7	7	20	*
Mars	2018	3	0	10	1	15	20	
	2019	0	1	5	0	10	5	*
Prill	2018	11	13	0	0	18	25	
	2019	0	4	0	2	1	0	*
Maj	2018	0	0	0	0	15	7	
	2019	0	0	0	0	0	0	*
Qershor	2018	0	0	0	0	18	1	
	2019	0	0	0	0	0	0	*
Korrik	2018	0	0	0	1	0	0	
	2019	0	0	0	0	0	0	*
Gusht	2018	0	0	0	0	10	0	
	2019	0	0	0	0	0	0	*
Shtator	2018	3	2	0	0	19	2	
	2019	0	0	0	0	0	0	*
Tetor	2018	12	4	0	0	14	17	
	2019	3	6	0	4	3	0	*
Nentor	2018	17	13	0	0	11	20	
	2019	0	0	10	9	2	7	*
Dhjetor	2018	18	15	19	17	10	28	
	2019	12	12	14	16	6	6	*
Totali	2018	82	75	29	30	148	153	
	2019	33	48	63	59	42	65	*

Nga vlerësimi i gjendjes së cilësisë se ajrit për vitet 2018/2019, duke analizuar mesataret mujore për parametrat PM10 dhe PM2.5, konstatohet se kemi tejkalime të VML. Normat mbi vlerat maksimale të lejuara janë vlerësuar më të larta veçanërisht gjatë sezonës vjesht-dimër, si dhe në ato lokalitete ku ka pasur intensitet të punëve në infrastruktur. Shkaqet e ndotjes së rritur gjatë muajve të dimrit janë të njëjtit: trafiku i rënduar nga automjete të vjetra, ngrohja me lëndë djegëse si thëngjilli, druri, peleti, karburante si derivate të naftës, ndotja nga energjetika, operatorët industrial dhe ekonomik , mostrajtim i mbetjeve, etj. Nuk përjashtohet ndikimi nga ndotja e ndërsjellët ndërkufitare me shtetet e rajonit.

Trendi i cilësisë së ajrit 2013-2019

Bazuar në të dhënat të ofruara nga rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit të IHMK, prej vitit 2013-2019, janë kalkuluar mesataret vjetore për SO_2, NO_2, O_3, CO, PM10 dhe PM2.5 në nivel vendi. Trendi i paraqitur në formë grafike nxjerr në pah tendencat e rritjes së SO_2 dhe NO_2, ndërsa tek parametrat PM10 dhe PM2.5 dhe parametrave tjerë vërehet tendencë e rënies së vlerave mesatare (fig.2-fig.7). Është e vështirë të diskutohen shkaqet e këtyre trendëve, nga shkaku se në vitet 2013, 2015, 2016 dhe 2017 nuk kishte matje kontinuale të të gjitha parametrave në fjalë. Viti 2018 karakterizohet me mbulueshmëri të kënaqshme të monitorimit (mbi 75 %) ndërsa vitet tjera nuk e kanë mbuluar minimumin e mbulueshmërisë kohore-mbi 75 %.



Fig.2. Trendi i vlerave mesatare vjetore të SO_2 për vitet 2013-2019



Fig.3. Trendi i vlerave mesatare vjetore të NO_2 për vitet 2013-2019



Fig.4. Trendi i vlerave mesatare vjetore të O_3 për vitet 2013-2019



Fig.5. Trendi i vlerave mesatare vjetore të CO për vitet 2013-2019



Figura 6. Trendi i vlerave mesatare vjetore të PM10 për vitet 2013-2019



Fig.7. Trendi i vlerave mesatare vjetore të PM2.5 2013-2019

1.2. Uji

Zhvillimi industrial, urbanizimi, bujqësia intensive janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore.

Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujorë. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç'rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj.) dhe atyre organike (PCB, Herbicide etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujorë janë shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vendmostrime (stacion monitoruese). Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizikë (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Në shtojcën 2 dhe 3 të raportit, janë prezantuar stacionet monitoruese të lumenjve, parametrat që monitorohen dhe frekuenca e matjeve.
Në këtë raport gjendjen e ujërave është pasqyruar përmes treguesve (parametrave): Oksigjeni i tretur (mg/l O_2); Shpenzimi biokimik i oksigjenit- $SHBO_5$ (mg/l O_2), Shpenzimi kimik i oksigjenit- SHKO (mg/l O_2); Karboni organik total-C (mg/l); Fosfori total – P (mg/l), Materiet totale të suspenduara-MTS (mg/L). Vlerat e prezentuara në grafikon janë si vlera mesatare për vitet 2018 dhe 2019.
Parametrat si: oksigjeni i tretur (O2), oksigjeni biokimik i shpenzuar për 5 ditë ($SHBO_5$), shpenzimi kimik i oksigjenit (SHKO), tregojnë nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujit i cili hynë në grupin e parametrave të cilët pritet të kenë presione nga ato dukuri që u cekën më lartë. Derisa, prezenca e fosforit (P_{tot}) shkakton eutrofikimin në ujëra.

Pellgu i Drinit të Bardhë – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruse është bërë për dy lumenjtë: lumi Drini i Bardhë dhe lumi Ereniku, ku si vlera mesatare vjetore të ngritura paraqiten shpenzimi kimik i oksigjenit /mg/l O_2 (SHKO) dhe atë në stacionet monitoruese përgjatë rrjedhjes së lumenjëve duke përjashtuar stacionet referente (vendburimet).



Figura 8: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve- IHMK 2018-2019 (Pellgu i Drinit të Bardhë)

Pellgu i Ibrit – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për këta lumenjë: Ibri, Sitnica, Prishtevka, Graqanka dhe Drenica (figura 9), nga ku vërehet se lumi Prishtevka/Bresje, pothuajse me të gjithë parametrat e paraqitur tregon vlera më të ngritura, ngase vetë shtrirja e lumit është përgjatë zonës më të populluar dhe që përfshinë edhe zona industriale.



Figura 9: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjve- IHMK 2018-2019 (Pellgu i Ibrit)

Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit - Në pellgun Morava e Binçës është përzgjedhur lumi Morava e Binçës me gjithsej katër stacione monitoruese (figura 10), ku pothuajse në të gjitha stacionet monitoruese ka ngritje të këtyre gjashtë parametrave. Ndërsa në Pellgun Lepencit, janë përzgjedhur dy lumenj: ai i Lepencit dhe Nerodimja.



Figura 10: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjve- IHMK 2018-2019 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit)

Bazuar në këto tri grafikone (shtrirjen territoriale në të gjitha pellgjet) ku prezenca e sasisë së fosfori total/ mg/l P nga analizat e bëra gjatë kësaj periudhe tregojnë se sasia e fosforit në ujërat e lumenjve nuk paraqet ndikim të shprehur në ujërat sipërfaqësore, sepse vlerat e tij të paraqitura në diagramet për vitin 2018 gjendet në mes 0.05 mg/l P (Ibri / Kushtovë) dhe 3.35 mg/l P (Prishtevka/Bresje) derisa për vitin 2019 kjo vlerë bie në 2.30 mg/l P. Nga konstatojmë se ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuar me eutrofikim.

Po ashtu, edhe treguesi Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit ($SHBO_5$), gjatë periudhës së monitorimit për vitin 2018, tregon se vlerat e përllogaritura gjenden në mes të 0.33 mg O_2/l (Lepenci/ Prevallë Subain) dhe 59.03 mg O_2/l, në lumin Prishtevka / Bresje, nga ku për vitin 2019 shënohet ngritje 72.30 mg O_2/l. Ku për të dy vitet lumi Prishtevka / Bresje tregon për ndotje me vlerën më të lartë mesatare vjetore.

Edhe pse në kushte natyrore ujërat e pastra nuk posedojnë fare sasi të $SHBO_5$, kjo ndotje arsyetohet me faktin që ujërat sipërfaqësore i ekspozohen gjithnjë dhe gjithandej më shumë shkarkimeve të ujërave të ndotura përmes të cilave dhe krijohen kushte optimale për rritjen e vlerës së $SHBO_5$.

Trendi i ndryshimit të gjendjes së ujërave për vitet 2018 dhe 2019, për stacionet përktëse monitoruse për treguesit e përfshirë në këtë vlerësim është prezantuar në tabelën 19.

Tabela 19: Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve 2018-2019

Stacionet monitoruese	**Oksigjeni i tretur/ mg/l O_2**	**Shpenzimi biokimik i oksigjenit/ mg/l O_2 ($SHBO_5$**	**Shpenzimi kimik i oksigjenit/ mg/l O_2 (SHKO)**	**Karboni organik total/ mg/l C**	**Fosfori total/ mg/l P**	**Materiet totale të suspenduara/ mg/L (MTS)**
RV01_011	↑	↓	↓	↓	↑	↔
RV01_012	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV01_013	↓	↓	↓	↓	↓	↑
RV01_071	↑	↓	↓	↓	↓	↑
RV01_072	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV02_011	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_012	↓	↓	↑	↑	↓	↑
RV02_013	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_023	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_024	↓	↑	↑	↑	↑	↓
RV02_026	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_041	↑	↑	↑	↑	↓	↑
RV02_051	↓	↑	↑	↑	↑	↓
RV02_061	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_062	↓	↓	↓	↑	↓	↓
RV03_011	↓	↑	↑	↑	↓	↓
RV03_012	↑	↑	↑	↑	↓	↑
RV03_013	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV03_014	↓	↓	↑	↓	↓	↓
RV04_011	↓	↓	↓	↓	↓	↔
RV04_012	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV04_013	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV04_021	↓	↓	↓	↓	↓	↑
RV04_023	↓	↑	↓	↓	↓	↓
RV04_024	↓	↑	↑	↑	↓	↓



Figura 11: Rrjeti i ujrave sipërfaqësore në Kosovë

Monitorimi i sasisë së ujërave

Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga disa stacione matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Në këto stacione matet Niveli (H) dhe Prurja (Q). Në tabelën 20 janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (cm), ndërsa në tabelën 21 të dhënat për prurjet *Q (*m3/sec*)*, në stacionet hidrometrike sipas matjeve të realizuara për vitet 2018 dhe 2019.

Tabela 20: Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse 2018 - 2019[4]

Stationi	Mes. (cm)		Max. (cm)		Min. (cm)	
Viti	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjonaj	328	191	632	325	151	143
Këpuz	132	107	446	269	71	64
Gjakovë	83	130	351	364	34	79
Deçan	40	37	108	102	28	29
Grykë	80	72	170	150	43	47
Vllashnje	62	78	151	158	34	41
Prizren	53	51	143	134	32	29
Piranë	124	106	406	211	97	86
Mirushë	*[5]	52	*	113	*	33
Klinë	68	66	211	130	52	50
Berkovë	102	91	187	186	79	71
Leposaviç	178	148	448	242	120	119
Vragoli	86	53	250	104	50	38
Nedakovc	166	176	340	215	135	157
Drenas	*	95	*	197	*	37
Milloshevë	170	125	423	207	98	98
Lluzhan	109	83	441	160	64	69
Lipjan	*	28	*	79	*	12
Konçul	255	217	560	377	186	172
Viti	36	41	107	96	23	24
Domorovc	50	102	146	170	28	80
Kaçanik	*	42	*	76	*	29
Mlikë	90	86	145	137	60	61

*Tabela 21: Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (*m3/sec*) sipas stacioneve matëse 2018-2019*[6]

Stationi	Mes.(m3/sec)		Max.(m3/se)		Min.(m3/sec)	
Viti	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Deçan	1.212	0.846	10.623	9.229	0.383	0.418
Grykë	12.42	9.3	73.807	53.617	2.207	2.77
Drelaj	9.975	-	49.751	-	2.77	-
Gjonaj	-	34.097	-	209.032	-	9.576
Prizren	3.06	2.863	33.434	28.319	0.73	0.568
Lluzhan	5.135	1.811	89.829	8.176	0.937	1.12
Kaçanik	1.327	1.02	5.822	2.322	0.569	0.598
Mlikë	2.558	2.3	7.737	6.762	0.953	0.991

[4] *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës*

[5] *Informatë sqaruese: Stacionet: Mirushë, Drenas, Lipjan, Kaçanik janë stacione të rifunksionalizuara në vitin 2019, prandaj për vitin 2018 nuk ka të dhëna nga këto stacione.*

[6] *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës*

1.3. Toka

Toka është një resurs natyrorë që duhet mbrojtur. Madje, shkalla e civilizimit njerëzor vlerësohet e varet nga menaxhimi dhe trajtimi që i bëhet tokës. Nga toka shfrytëzohen të gjitha resurset të nevojshëm për njeriun. Mbetet sfidë kryesore menaxhimi i qëndrueshëm i tokës. I gjithë sistemi ekologjik varet nga trajtimi i tokës që bëhet.

Në Kosovë toka është shfrytëzuar për destinime të ndryshme dhe në shumicën e rasteve është shfrytëzuar pa ndonjë planifikim paraprak. Degradimi i tokës dhe konsumi i saj në formën e pakthyeshëm janë njëri ndër problemet me të mëdha në vend. Humbja e sipërfaqeve të tokës të shfrytëzueshëm jo vetëm që po ndikon në zvogëlimin e sipërfaqeve për riprodhim të ushqimit, por në të njëjtin kohë edhe në humbjen e shumë habitateve dhe diversitetit biologjik. Kontaminimi i tokës në shumë pjesë të vendit, të cilat njihen edhe si hotspote mjedisore është edhe një formë tjetër e humbjes së tokës si rezultat i mbetjeve të gjëndëruar nga industria, minierat, transporti, materiet radioaktive dhe mbeturinat urbane.

Menaxhimi i të dhënave për tokat e degraduara dhe ato të konsumuara akoma nuk janë të nivelit të kërkuar. Kjo mungesë e të dhënave është si pasojë e një komunikimi jo të qëndrueshëm ndërmjet komunitetit, institucioneve lokale dhe qendrore. Në mënyrë që të kemi një planifikimi të mirëfilltë për shfrytëzimin e tokave, si për prodhime bujqësore, ndërtim apo veprimtari ekonomike nevojiten të kemi një databazë me të dhëna të sakta.

Shfrytëzimi i tokave

Shfrytëzimi i tokës karakterizohet me format dhe përdorim të ndryshme për interesa jetësorë. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës qoftë në aspektin e infrastrukturës apo edhe për shfrytëzim bujqësore i referohet sipërfaqes së përgjithshme të tokës së konsumuar, tokës së punueshme, livadhet dhe kullosat, kulturat shumëvjeçare dhe kopshtet e përdorura nga ekonomia bujqësore, pavarësisht nga lloji i zotërimit.

Sipas inventarit te pyjeve, pyjet dhe tokat pyjore përfaqësojnë kategorinë kryesore të shfrytëzimit të tokave me rreth 47%, tokat bujqësore me rreth 29%, livadhet dhe kullosat me 15%, vendbanimet me rreth 4.5%, ujërat dhe tokat e lagura me rreth 0.6% kurse tokat tjera me rreth 3.9 %.

Sipas të dhënave të Anketës së Ekonomive Bujqësore, gjithsej sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore janë 416 mijë ha (2017), prej të cilës pjesa më e madhe i përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) 218.3 mijë ha ose 52.5%, ndërsa tokë e punueshme-ara (duke përjashtuar perimet) janë 186.9 mijë ha ose 44.9%.[7] Në vitin 2018 sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore janë 419 mijë ha. Prej tyre 218.152 ha janë livadhe, kullosa dhe 188 mijë ha toka punueshme.

[7] *Raporti i gjelbër, 2018/MBPZHR*

Në këtë kontekst degradimi i tokave vjen edhe nga prerja e pyjeve. Vetem në vitin 2018 demi pyjor vlerësohet të jetë 14019 m^3 . Djegiet e qëllimshme të pyejeve në krejt territorin e vendi vlerësohen të jenë 949 ha ndërsa janë pyllëzuar 296 ha. Nga poashtu në rivitalizimin e tokave pyjore kemi një progres të vogël, çka ky rehabilitim vetem nga shfrytëzimi i inerteve është bërë vetëm me një sipërfaqe mbi 10 ha. gjëndje Nga kjo shihet se në rivitalizimin e tokave pyjore kemi një trend jo të mirë.[8]

Mbulushmëria e tokave - Sipas të dhënave nga imazhet satelitore të vitit 2018, që janë përpunuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në kuadër të projektit Implementimi i CLC[9] 2018 në vendet e Ballkanit Perëndimor, i mbështetur nga Agjencia e Mjedisit të Evropës, në Kosovë janë identifikuar 30 klasa të mbulueshmërisë së tokave nga 44 sa ka gjithsej nomenklatura CORINE[10].
Këto klasa janë grupuar në 5 klasa kryesore ku dominojnë pyjet dhe zonat gjysmë-natyrore me rreth 57% dhe tokat bujqësore me rreth 38 %, ndërsa sipërfaqet artificiale përfaqësohen me mbi 4.6% të totalit. Rreth 0.3 % e tokave të mbuluara klasifikohen në klasën e trupave ujorë dhe zonave të lagura (ligatinat)[11]. Këto klasa të tokave të përdorur në ha gjatë viteve 2000-2018, janë të paraqitur në tabelën 22, ndërsa në figurën 12 është paraqitur harta e kategorive të shfrytëzimit të tokave për vitin 2018 sipas kategorive të CLC.

Tabela 22: Përdorimi i tokës (ha) sipas kategorive 2000, 2006, 2012 dhe 2018[12]

Tipi	ha 2000	ha 2006	ha 2012	ha 2018
Sipërfaqet artificiale(zona ndërtuese)	24978.47	32919.39	50597.97	51057.52
Zona bujqësore	444320.72	439971.2	416336.95	416168.22
Pyjet dhe fushat gjysmë natyrore	618895.06	614290.59	621110.61	620819.78
Toka te lagta	0	985.101	131.348	131.348
Trupat ujor	2323.47	2351.43	2340.84	2340.84
Gjithsejt	1090517.7	1090517.7	1090517.7	1090517.7

[8] *Raporti i gjelbër, 2019/MBPZHR*
[9] *CLC - Corine Land Cover (Mbulushmeria e tokave sipas metodologjisë CORINE)*
[10] *Coordination of information on the environment/Koordinimi i të dhënave në mjedis*
[11] *Implementation of CLC2012 in the West Balkan Countries/EEA 2014*
[12] *Inventari i Pyjeve të Kosovës 2012/APK*



Figura 12: Harta e mbulushmerisë së tokave sipas kategorive të CLC

Monitorimi i tokave

Institucionet përgjegjëse për monitorim të tokave janë; Instituti Bujqësor i Kosovës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Të dy këto institucione veprojnë në kuadër te ministrive përkatëse. Instituti Bujësor i Pejës përpos kompetenca për përcjelljen e inputeve bujqësore, ushqimit dhe ruajtjës së ambientit jetësor, bonitetit të tokave, kryen edhe shumë aktivitete teknike dhe shkencore që ndërlidhen me anlizën e tokave.[13]

Ligji për rregullimin e tokës (Nr. 04/L-040, 2012), përcakton institucionet përgjegjëse për rregullimin e tokës si; Ministria, Komunat, Agjencinë Kadastrale e Kosovës dhe Zyra Kadastrale e Komunave.

Një studim për ndotjet e tokave bujqësorë është realizuar në saje te fondeve te EU dhe i implementuar nga GIZ dhe NIRAS. Projekti është realizuar brenda 2 viteve 2013-2014. Ky projekt ka monitoruar tokat bujqësore të 17 komunave të Kosovës i cili ka përfshirë 214.749 ha. Si pjesë të kontaminuar kanë rezultuar tokat afër vendeve industriale.

Në bazë të vlerësimeve të të dhënave konkludojmë se degradimi i tokave, shfrytëzimi pa kriter për disa sektorë të veçanta është si rezultat i disa faktorëve, si;

- ✓ Mungesa e planifikimit për shfrytëzim të tokave nga ana e institucioneve lokale
- ✓ Mos zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore për token;
- ✓ Ndotja e tokave nga mbetjet industriale, minerare, mbeturinave;
- ✓ Ndotja e tokave nga bujqësia me përdorimin e preparateve ndaj dëmtuesve bimore etj.
- ✓ Degradimi i tokave nga eksploatimi, ndërtimet dhe erozioni;
- ✓ Shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe industriale
- ✓ Vendbanimet e shpërndara dhe betonimi i tokës;
- ✓ Ndërtimet e shumta ilegale dhe kaosi urban;
- ✓ Fragmentimi i tokave në parcela të vogla dhe humbja e funksioneve të tyre;
- ✓ Mungesa e komasacionit apo rregullimit të tokave ne aspektin agroteknik-gjeodezik dhe çështjet pronsore juridike të tokave qoftë ndarja apo bashkimi i tyre.
- ✓ Mungesa e sistemit informative për tokat;
- ✓ Mungesa e përvojës për shfrytëzim të qëndrueshëm të tokës nga komunat;
- ✓ Mungesa hartimit dhe zbatimin te politikave të qëndrueshëm për menaxhim të tokave.

[13] *www.mbpzhr-ks.net*

1.4. Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

Kronologjia e shpalljes së zonave të mbrojtura

Në kronologjinë e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë mund të veçohen tri periudha kohore të cilat lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë.

Periudha 1950 - 1970, paraqet fazën iniciale të mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë e cila fillon me shpalljen e zonës së parë në vitin 1950, që ishte "Gazimestani". Deri në fillimin e viteve të 70-ta, numri i zonave të mbrojtura arrinte në 19. Në këtë periudhë nën mbrojtje vihen: Shpella e Gadimes dhe disa monumente të tjera me rëndësi botanike si: Rrapi në Marash, Trungjet në Isniq, etj. Periudha në mes viteve 1970 - 1988, karakterizohet me shpalljen e numrit të konsiderueshëm të zonave të natyrës. Arsyeja e këtij suksesi është e lidhur me themelimin e Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 1974, nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë periudhë, nën mbrojtje janë vënë gjithsej 32 zona të natyrës prej të cilave duhet veçuar: rezervati "Bifurkacioni i Lumit Nerodime", Parku i parë Kombëtar "Mali Sharr"(1986), Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc (1983) si dhe disa monumente të tjera të natyrës.

Periudha pas vitit 2000, karakterizon rithemelimin e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Gjatë kësaj periudhe nën mbrojtje ligjore janë marrë mbi 170 zona te ndryshme dhe janë propozuar për mbrojtje edhe shumë të tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura duhet veçuar: Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"(2013), PK "Sharri" (i zgjeruar), Ligatina e Hencit - Radevës etj., ndërsa shumicën e përbëjnë monumentet e natyrës me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, etj.



Fig. 13. Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 – 2019[14]

[14] *Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës*

Zonat e Mbrojtura të Natyrës

Gjatë vitit 2019 numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura u janë shtuar edhe 16 zona të reja të mbrojtura (15 monumente të natyrës dhe një(1) peisazh i mbrojtur) - në territorin e komunave Mitrovicë dhe Obiliq: Ahishtat e Llomovës në Selac, Shpellat e Kaçandollit në Kaçandoll, Ujëvara e Trepçalive në Milenicë, Kroni i Akullit në Rahovë, Trungjet e Ahut (Fagus sylvatica) në Bajgorë , Trungjet e rrënjës (*Quercus robur*) në Sibovc, Trungu i manit (*Morus nigra L.)* në Mazgit , Burimi i ujit mineral në Graboc i Epërm etj. Në të njëjtën periudhë janë evidentuar vlerat natyrore në komunën e Prizrenit dhe janë përgatitur studimet (arsyshmëritë profesionale) për vlerat e natyrës në komunat Viti dhe Gjilan, të cilat janë proceduar për miratim në asambletë përkatëse komunale.

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2019) është 210 të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 1251814.1 ha, ose 11.53% e sipërfaqes të Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 19 Rezervate Strikte të Natyrës ("Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", "Kamilja", etj), 2 Parqe Kombëtare ("Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"), 182 Monumente të Natyrës ("Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit", "Shpella e Gadimës", "Ujvarat e Mirushës", "Gryka e Rugovës", "Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj), 1 Park i Natyrës ("Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës"), 5 Peizazhe të Mbrojtura ("Shkugëza","Pishat e Deçanit"etj) dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve ("Ligatina e Hencit-Radeves"). Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", Parku i natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës", Peizazhi i Mbrojtur "Germia" dhe MNRV "Ujëvarat e Mirushës" etj.

Tabela 23. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive 2019

Kat. e IUCN-	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja /ha	Pjesë. ne siper. e	Pjesë. e ZM në
I	Rezervatet Strikte të Natyrës	19	10,882.92	7.7	0.99
II	Parqet Kombëtar	2	115,957	82.2	10.6
III	Monumentet Natyror	182	6,039	4.3	0.56
V	Park Natyre	1	5,934	4.2	0.5
V	Peizazh i Mbrojtur	5	2.152	1.5	0.2
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109.5	0.08	0.01
	Totali	**210**	**125814.1**[15]	**100**[16]	**11.53 %**

[15] *Sqarim: Perqindja është nxjerr nga siperfaqja e pergjithshme duke perfshirë edhe siperfaqen e zonave të mbrojtura brenda parqeve kombëtare.*

[16] *Sqarim: Perqindja është nxjerr nga siperfaqja e pergjithshme duke perfshiër edhe siperfaqen e zonave të mbrojtura brenda parqeve kombëtare.*



Figura 14: Harta e zonave të mbrojtura të natyrës sipas kategorive

Biodiversiteti

Vendi ynë në saje të pozitës gjeografike që ka, paraqet një regjion shumë të pasur në aspektin e biodiversitetit. Klima dhe kushtet ekologjike kanë mundësuar ekzistencën e florës dhe vegjetacionit të begatshëm me prani të formave barishtore, shkurre dhe drunore.

Duke pasur parasysh rendësin që ka biodiveristeti është e qartë se ruajta dhe ndërmarrja e masave parandaluese është detyrë shumë e rëndësishme që ndikon direkt në mbrojtjen e tij.

Flora

Disa lloje bimore janë endemik të Ballkanit, pra gjenden nëpër hapësirën ballkanike. Në vendin tonë mendohet se gjenden 2600 – 2800 lloje të ndryshme të bimëve të larta, në mesin e tyre përveç llojeve endemike ka edhe lloje stenoendemike. Këto të fundit janë lloje të cilat rriten vetëm në vendin tonë dhe askund tjetër dhe janë gjithësejtë shtatëmbdhjetë (17-të) lloje.

Bimët stenoendemike janë të përhapura në vende të caktuara dhe kryesisht kanë shtrirje të vogël në aspektin hapësinor, numri i ekzenplarëve të tyre është i vogël dhe janë të pasura në aspektin floristik, rriten kryesisht në territorin e Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna".



Figura 15: Llojet bimore me status ndërkombëtar në PK "Sharri"

Prej numrit të përgjithshëm të bimëve rreth 2000 lloje vaskulare të evidentuara në Malet e Sharrit, 86 lloje janë shpallur të rëndësishme në aspektin ndërkombëtar, 26 lloje janë të përfshira në Listën e Kuqe të Evropës, ndërsa sipas kritereve të IUCN-së, 32 lloje janë në Listën e Kuqe të Bimëve të Kërcënuara.

Në Bjeshkët e Nemuna janë evidentuar 797 lloje të bimëve vaskulare, ku 128 prej tyre konsiderohen me karakter endemik. Flora e Kosovës është e përfaqësuar edhe me lloje që kanë areal të ngushtë e që konsiderohen si lloje bimore të rralla e të rrezikuara. Këto pasoja negative janë si rezultat i përdorimi ilegal dhe keqpërdorimit të llojeve bimore që njëkohësisht ndikon në reduktimin e tyre.

Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës është dokument për florën e cila është prezente por që mund të zhduket. Ruajtja e diversitetit floristik dhe ndërmarrja e masave parandaluese është detyrë shumë e rëndësishme që ndikon direkt në mbrojtjen globale të mjedisit. Shkatërrimi i florës dhe faunës ndodh si pasojë e veprimit të faktorit antropogjen nga pakujdesi, mos interesimi dhe mos dija. Si pasojë, sot në botë edhe në Kosovë janë shkatërruar habitate të ndryshme me ç'rast janë zhdukur lloje bimore dhe shtazore që janë të panjohura për shkencën[17].

[17] *Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikes të Kosovës - Prishtinë, 2013*



Fiigura 16: Numri i llojeve bimore sipas kategorive të kërcënueshëmrisë

Në bazë të monitorimeve që janë bërë gjatë vitit 2018, në zonat e mbrojtura, të kategorisë së parë ku bëjnë pjesë Rezervatet Strike, të cilat janë në kaudër të Parqeve Kombëtar "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna", është konstatuar gjendja relativisht e mirë e llojeve të bimëve me karakter endemik, stenoendemik, mjekësor etj.

Gjithashtu duhet permenduar faktin se shfrytëzimi pa kriter i disa llojeve bimore, me theks të veçantë atyre me karakter mjekësor siç është, Sanëza (*Gentiana lutea*) dhe të tjera, ka ndikuar në dëmtimin jo vetëm të llojeve po edhe habitateve të tyre. Pjesa më e madhe e këtyre ndikimeve vijnë si rezultat i veprimit të faktorit njeri, duke ndikuar kështu në reduktimin e vlerat natyrore dhe biodiveristetit në rezervate, sipas të cilave janë shpallur në kategorinë e parë të mbrojtës.

Bazuar në studimet e deri tanishme këto zona paraqesin potencial shumë të rëndësishëm në aspektin e vlerave natyrore dhe biodivcersitetit. Mirëpo meqenëse në disa pjesë gjendja ka ndryshuar, si rezultat i ndërhyrjeve në to dhe duke marrë parasysh faktin se njohja e vlerave të përgjithshme të tyre është i nevojshëm, konsiderojmë se vazhdimi i studimit në to, është shumë i rëndësishëm. Njëherit kjo do të mundësonte identifikimin e saktë të pjesëve të tyre si zona qendrore që shquhen me vlera të veçanta natyrore dhe biodiveristetit. Kjo do të konsiderohet si bazë e mirë për përcaktimin e saktë të zonave të cilat duhen të mbrohen, ruhen dhe konservohen edhe në të ardhmen.



Foto: Kullotja e deleve në Rezervatin Strikt "Shutman"

Vegjetacioni

Kosova shquhet me një vegjetacion mjaft te pasur qe formojnë ekosisteme karakterisitke , të cilat janë gjithashtu habitate për shumë lloje shtazore. Pyjet më të zhvilluara gjendet në kuadër të Parqeve Kombëtare: "Mali Sharr" dhe "Bjeshkët e Nemuna", vegjetacioni i tyre përbëhet nga tre breza vegjetativ: brezi i ulët malor, brezi i mesëm malor dhe brezi i lartë malor.

Këto bashkësi pyjore paraqesin ekosisteme shumë të rëndësishme, që si të tilla duhet të ruhen sepse me ruajtjen e këtyre resurseve krijohen kushte për ruajtjen edhe të llojeve bimore dhe shtazore. Mirëpo në disa raste janë shkaktuar ndërhyrje në vegjetacionin pyjor, si rezultat i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në mjedis, si për shembull ndërtimi i rrugëve, prerja ilegale, djegia, aktiviteti i gurëthyesve etj. Prandaj, këto dukuri kanë shkaktuar ndikime negative në vlerat natyrore dhe të ekosistemeve në përgjithësi.



Foto: Dëmtimet e vegjetacionit pyjor në kuadër të zonave të mbrojtura

Fauna

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit në zonat e mbrojtura të natyrës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës - IKMN edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar së realizuari aktivitetin e monitorimit të faunës së egër përmes kamerave- kurth në zonat e mbrojtura të natyrës, me theks të veçantë në të dy Parqet Kombëtare, "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna". Kjo metodë e monitorimit të faunës së egër, e filluar që nga viti 2016, gjeneron informacione në lidhje me praninë e llojeve të ndryshme pa i shqetësuar ato.

Gjatë këtij aktiviteti të realizuar në mënyrë të përbashkët me zyrtarët e të dy Parqeve Kombëtare është bërë vendosja e kamerave -kurth kryesisht në pjesët ku besohet se janë zona të mundshme të lëvizjes së numrit më të madh të kafshëve të egra.

Në shumicën e vendeve ku ishin vendosur kamerat janë fotografuar dhe regjistruar llojet e ndryshme të gjitarëve që më parë mendohej se nuk janë prezent në ato pjesë si: Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Ujku (*Canis lupus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes martes*), Baldosa (*Meles meles*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Lepuri (*Lepus europaeus*), Macja e egër (*Felis sylvestris*) etj.



Foto: Disa nga llojet e faunës të regjistruara me kamera- kurth gjatë vitit 2019

Libri i Kuq i Faunës

Në kuadër të Programit Mjedisor i Kosovës (PMK) financuar nga Qeveria Suedeze - SIDA, është realizuar projekti (komponenta e dytë) Inventarizimi i biodiversitetit përmes Librit të Kuq të Faunës. Në kuadër të projektit për hartimin e Librit të Kuq të Faunës janë realizuar një numër i madhe i aktiviteteve si: Përgatitja e metodologjisë së punës për hartimin e librit të Kuqë të Faunës (sipas kritereve të IUCN) , hartimi i planit të punës, përgatitja e termave të referencave për ekspertet, përgatitja e përmbajtjes së Librit të Kuq të Faunës. Realizimi i këtij projekti ka rendësi të madhe për MMPH, MBPZHR, UP, QJQ ,etj, se për herë të parë në Kosovë behet inventarizimi i faunës dhe në baze të dhënave të librit të kuq të faunës do të hartohen politikat dhe strategjitë për mbrojtjen dhe konservimin e faunes në Kosovë.

Ne Librin e Kuq te Faunës te Republikës se Kosovës janë përfshire gjithësej 306 lloje, te cilat u takojnë këtyre grupeve te shtazëve: Gastropoda, Bivalvia, Oligochaeta, Hirudinea, Arachnida (Araneae, Mesostigmata), Malacostraca, Diplopoda, Insecta (Ephemeroptera, Plecoptera, Odonata, Coleoptera, Mecoptera, Diptera, Trichoptera, Lepidoptera), Cyclostomata, Actinopterygii, Amphibia, Reptilia, Aves dhe Mammalia. Numri i llojeve te vëzhguara është shumë më i madh, por për shkak te hapësirës së kufizuar, vlerësimi është bërë vetëm për këto lloje.

Gjatë implementimit të Komponentës së Dytë për Librin e Kuq në kuadër të Programit Mjedisor të Kosovës në aktivitetet e hulumtimit te kafshëve, është gjetur një lloj i ri për shkencën, i cili i takon grupit Insecta, rendit Trichoptera dhe gjinisë Potamophylax, grupit Juliani, qe është grup endemik i Ballkanit me përhapje te ngushte.

Një numër i madh i llojeve të Ephemeroptera-ve, Coleoptera-ve, Mollusca-ve, Araneae-ve dhe të tjera bëjnë pjese në këtë grup te materialit të paidentifikuar ende, dhe përfundimi i përcaktimit të tyre mund te krijoje rezultate të rëndësishme për faunën e Republikës se Kosovës. Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës te Republikës se Kosovës i takon grupeve: Insecta (140 lloje), Mammalia (39), Aves (24), Reptilia (20) dhe Gastropoda (20), kurse grupet e tjera janë te përfaqësuara me numër me të vogël të llojeve.

Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës i takon kategorive: Të dhëna të Pamjaftueshme (gjithsej 90) dhe Gati i Kërcënuar (gjithsej 80), kurse numri me i vogël i llojeve i takon kategorive: I Rrezikuar (24) dhe Skajshmërish i Rrezikuar (25).

Këto të dhëna reflektojnë gjendjen faktike në hulumtimet e diversitetit shtazor në Kosove, ku akoma ka mungesa thelbësore për një numër te madh te llojeve sa i përket te dhënave rreth popullatave, numrit te individëve, trendit te tyre dhe faktorëve qe i kërcënojnë. Ky është një paralajmërim emergjent që të fillohet monitorimi i llojeve te tilla, ne mënyre qe llojet te cilat nuk kanë mundur të vlerësohen për kategoritë e kërcënueshëmerisë për shkak te mungesës se te dhënave, të vlerësohen drejt, para se ato të rrezikohen në mënyre të pakthyeshme prej rreziqeve antropogjene dhe te tjera.

Numri më i madh i kërcënimeve për llojet e vlerësuara i takon këtyre grupeve të kërcënimeve: përdorimi i burimeve biologjike, modifikime të sistemeve natyrore, ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër, ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore, ndotja dhe zhvillimi rezidencial dhe komercial. Prerja dhe vjelja e pyjeve, aktivitetet rekreative të pa menaxhuara mirë, eksploatimi i ujërave sipërfaqësore (veçanërisht për qëllime bujqësore), ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit dhe zonat e turizmit dhe rekreacionit janë rreziqet specifike më të shpeshta, që i kërcënojnë llojet e vlerësuara.



Figura 17. Numri i llojeve në kuadër të grupeve të ndryshme të kafshëve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës[18]

Figyra 17 prezanton nurmin dhe % e llojeve në kuadër të grupeve të ndryshme të kafshëve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës, ndërsa në tabelën 24 është prezantuar shpërndarja e llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës në gjashtë kategoritë sipas IUCN.

[18] *Libri i Kuq i Faunës së Kosovës, PMK/MMPH 2019*

Tabela 24. Shpërndarja e llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës në gjashtë kategoritë sipas IUCN

Grupet/Kategoritë	Skajshmërisht i Rrezikuar CR	I Rrezikuar EN	I Cenuar VU	Gati i Kërcënuar NT	Shqetësim më i Vogël LC	Të Dhëna të Pamjaftueshme DD	Totali
Gastropoda			10	10			**20**
Bivalvia		1					**1**
Oligochaeta		1		2	2	7	**12**
Hirudinea						2	**2**
Arachnida					1	8	**9**
Araneae					1	7	**8**
Mesostigmata						1	**1**
Malacostraca			1			1	**2**
Diplopoda			3			6	**9**
Insecta	20	11	19	42	13	35	**140**
Ephemeroptera		4		4	2	2	**12**
Plecoptera	5	1					**6**
Odonata				4	1	7	**12**
Coleoptera			3	2	4	17	**26**
Mecoptera						1	**1**
Diptera						2	**2**
Trichoptera	15	1	7	20	1	2	**46**
Lepidoptera		5	9	12	5	4	**35**
Cyclostomata				1			**1**
Actinopterygii	1	1	1	4	2	5	**14**
Amphibia		2	1		3	7	**13**
Reptilia			1	8	8	3	**20**
Aves	3	6	4	4		7	**24**
Mammalia	1	2	1	9	17	9	**39**
Totali	**25**	**24**	**41**	**80**	**46**	**90**	**306**

1.5. Mbeturinat

Gjendja në sektorin e mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës rregullohet me **Ligjin Nr. 64/L-060** për Mbeturinat si dhe me aktet tjera nënligjore. Me një zbatim të mirëfillt të bazës ligjore, si dhe me përcjelljen e trendeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave nga ana e akterëve të involvuar në këtë fushë, gjendja e mjedisit në Kosovë, do të vazhdoj të përmirësohet dhe të avancohet.

Duke filluar nga prodhimi e deri tek trajtimi përfundimtar i mbeturinave, e që deri më tani dominon deponimi klasik i tyre nëpër deponit sanitare, gjendja e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk është e mirë.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk ofron të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe eliminimin e mbeturinave. Në bazë të të dhënave rezulton se gjenerimi i mbeturinave komunale, spitalore dhe industriale është duke shënuar rritje nga viti në vit.

Gjendja e deponive sanitare në Kosovë vazhdon të jetë e rëndë si pasojë e shumë faktorëve, me theks të veçantë nga mos menaxhimi i duhur i deponive. Sa i përket deponive industriale të trashëguara nga aktivitetet minerare dhe industriale, por edhe atyre aktive, gjendja e tyre nuk është plotësisht e njohur, andaj, kërkohet që në të ardhmen të bëhet një vlerësim mjedisor i kësaj kategorie te deponive.



Foto: Deponia sanitare Prishtinë (Mirash)

Gjenerimi i mbeturinave komunale

Në nivelin lokal nuk është realizuar analizë e kompozicionit të mbeturinave e cila do të na ofronte të dhëna edhe për sasitë e gjeneruara të mbeturinave, në komuna të ndryshme, me të dhëna të diferencuara nga zona rurale apo urbane.

Sasia totale e mbeturinave të gjeneruara mund të llogaritet vetëm në bazë të një gjenerimi mesatar për banor.

Bazuar në raportin e menaxhimit të mbeturinave komunale për vitin 2018 dhe për vitin 2019, të dhënat për sasinë e grumbulluar të mbeturinave, dhe duke pas parasysh numrin e ekonomive familjare të shërbyera mund të llogarisim normën e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori (kg/dite), që në nivel vendi rezulton 0.78 kg/banorë/ditë për vitin 2018, respektivisht 0.73 kg/banorë/ditë për vitin 2019.

Duke marrë parasysh numrin prej 1,779,521 banorëve në vend (regjistrimi i popullsisë i vitit 2011) dhe sasinë vjetore të mbeturinave komunale për kokë banori, që është afërsisht 0.78 kg/ për banorë/ ditë për vitin 2018 dhe 0.73 kg/banorë/ditë për vitin 2019, sasia totale e mbeturinave të gjeneruara del afërsisht 506,629 ton/vit/2018, respektivisht 476,479.40 ton/vit/2019.

Tabela 25: Gjenerimi i mbeturinave komunale[19], 2018 dhe 2019

Rajoni	2018		2019	
	kg/b/vit	*kg/b/dit*	*kg/b/vit*	*kg/b/dit*
RAJONI I PRISHTINËS	232.95	0.64	247.00	0.68
RAJONI I MITROVICËS	338.34	0.93	274.38	0.75
RAJONI I PEJËS	376.74	1.03	383.13	1.05
RAJONI I PRIZRENIT	289.11	0.79	226.62	0.62
RAJONI I FERIZAJT	274.62	0.75	285.51	0.78
RAJONI I GJILANIT	297.28	0.81	344.45	0.94
RAJONI I GJAKOVËS	327.18	0.9	230.13	0.63
KOSOVË	**284.73**	**0.78**	**266.24**	**0.73**

[19] ***Informata sqaruese****: Raporti është gjeneruar nga raportimi i 33 komunave për vitin 2018 (nuk përfshihen komunat: Shtërpcë, Kllokot, Leposavic, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut), rrespektivisht nga raportimi i 36 komunave për vitin 2019 (nuk përfshihen komunat Leposaviq dhe Mitrovic e Veriut)*



Figura 18. Gjenerimi i mbeturinave, 2018 dhe 2019



Figura 19. Gjenerimi i mbeturinave, 2018 dhe 2019

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave

Mbulimi i përgjithshëm me shërbim të mbledhjes së mbeturinave deri në fund të vitit 2018 në nivel vendi qëndron në 75.6%, kurse në vitin 2019 kemi një rritje të mbulimit me shërbim për 2.10% krahasuar me vitin paraprak, pra gjithsej mbulimi me shërbim në nivel vendi në 2019 arrin në 77.70%

Disa komuna , si Prishtina, Fushë Kosovë, Prizren etj. figurojnë me mbulim 100%. Kjo ndodhë sepse numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbim (faturohen) është shumë më i madh se numri ekzistues i familjeve sipas regjistrimit të ASK- së (2011), për arsye se komunat qoftë kanë marrë përsipër arkëtimin nga operatori, dhe kanë filluar me një listë të zgjeruar të klientëve, duke i filtruar ato nëpërmjet të dhënave për tatimin në pronë, apo edhe nisur nga fakti se në disa komuna si p.sh. Fushë Kosovë, për shkak të rritjes së numrit të popullsisë në dekadën e fundit, regjistrimi i ASK-së i viti 2011, nuk reflekton gjendej reale, përkatësisht numri i ekonomive familjare është shumë më i madh se sa ai në regjistrimin e viti 2011.

Duhet të sqarohet po ashtu që në disa komuna veprojnë kompanitë private të licencuara për mbledhjen e mbeturinave, por të cilat nuk janë kontraktuar bazuar në procedura të prokurimit publik dhe rrjedhimisht, të dhënat (faturimet) që burojnë nga këto kompani nuk janë përdorur për llogaritje, dhe po ashtu për shkak të pamundësisë së verifikimit të dhënat e ofruara nga disa komuna nuk janë futur në llogaritje, çka ka ndikuar në rezultatet sa i përket mbulueshmërisë në disa rajone.

Tabela 26. *Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave sipas rajoneve dhe në nivel vendi në 2018 dhe në 2019*

Rajoni		Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2018)	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2019)	Rritja ose zbritja e shkallës së mbulimit 2018-2019 (pikë %)
R1	Rajoni i Prishtinës	80.40%	85.20%	4.70%
R2	Rajoni i Mitrovicës	82.70%	77.50%	-5.20%
R3	Rajoni i Pejës	78.10%	85.10%	7.00%
R4	Rajoni i Prizrenit	83.30%	95.20%	11.90%
R5	Rajoni i Ferizajt	58.30%	63.20%	4.90%
R6	Rajoni i Gjilanit	60.70%	55.40%	-5.30%
R7	Rajoni i Gjakovës	60.20%	72.50%	12.30%
	Kosovë	**75.60%**	**77.70%**	**2.10%**



Figura 20. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale 2018 dhe 2019

Deponitë ilegale

Bazuar në raportimin e komunave, i cili është i mbështetur në hulumtimin në terren, në mars të vitit 2019, ndërlidhur me vitin 2018 në nivel vendi janë identifikuar 2529, respektivisht nga hulumtimi në terren në qershor të vitit 2020 ndërlidhur me vitin 2019, janë identifikuar 1489 deponi ilegale. Kjo tregon për një zvogëlim të deponive ilegale prej 757 më pak krahasuar me hulumtimin paraprak. Siç vërehet në tabelën në vijim rajoni me më së shumti deponi ilegale në të dy hulumtimet ka dalë rajoni i Prishtinës, kurse me më së paku deponi ka rezultuar rajoni i Gjakovës.

Deponitë ilegale që janë identifikuar, janë klasifikuar sipas madhësisë dhe llojit të mbeturinave, përkatësisht si: deponi të mëdha, të mesme dhe të vogla, duke u bazuar në vëllimin e vlerësuar.

Sipas fraksionit të mbeturinave, deponitë ilegale janë klasifikuar si: (a) deponi të mbeturinave të amvisërisë; (b) deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit; (c) deponi të mbeturinave të rrezikshme-industriale; (d) deponi të mbeturinave të vëllimshme; dhe (e) deponi të mbeturinave të tjera (përziera).

Tabela 27: *Shpërndarja e deponive ilegale sipas rajoneve*

Nr.	Rajonet	Deponi ilegale gjithsej 2018	Deponi ilegale gjithsej 2019	Shtimi-eliminimi i deponive ilegale 2018-2019
R1	RAJONI I PRISHTINËS	582	313	-269
R2	RAJONI I MITROVICËS	221	222	1
R3	RAJONII PEJËS	342	141	-201
R4	RAJONI I PRIZRENIT	448	298	-150
R5	RAJONI I FERIZAJIT	158	127	-31
R6	RAJONI I GJILANIT	377	325	-52
R7	RAJONI I GJAKOVËS	118	63	-55
KOSOVË		2246	1489	-757





Figura 21 dhe 22. Deponitë ilegale sipas fraksionit 2018 - 2019



Figura 23: Harta e deponive ilegale në Kosovë për vitin 2019

Pajtushmëria me kornizën ligjore dhe planifkuese për menaxhim të mbeturinave

Korniza ligjore, duke përfshi ligjin për mbeturina dhe aktet tjera nënligjore, përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e komunave për menaxhim të mbeturinave brenda territorit të tyre. Poashtu dokumentet planifikuese në nivelin qendror, ofrojnë një kornizë zhvillimi për nivelin lokal dhe atë rajonal, dhe merr masa në realizim të caqeve dhe objektivave të përcaktuara.

Disa nga këto detyra kanë rëndësi thelbësore, për t'u mundësuar komunave implementimin e ligjit dhe planeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave, si:

- ✓ Hartimi dhe miratimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM),
- ✓ Hartimi dhe miratimi i Rregullores për Menaxhim të Mbeturinave,
- ✓ Punësimi i zyrtarit për menaxhim të mbeturinave me punësim të përhershëm, përshkrimi i punës i të cilit siguron që të paktën 50% e përgjegjësive janë në menaxhim të mbeturinave,
- ✓ Punësimi i inspektorit mjedisor, përshkrimi i punës i të cilit siguron përgjegjësi në fushën e menaxhimit të mbeturinave,
- ✓ Kontraktimi i operatorëve të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale, duke zbatuar procedurat e prokurimit,
- ✓ Kontraktimi i operatorëve të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, duke zbatuar procedurat e prokurimit,
- ✓ Caktim i tarifës së shërbimit duke kaluar procesin tarifor për grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale, përmes kalkulimit të kostove të shërbimit, profilizimin e klientëve dhe caktimin e tarifave të shërbimit, si dhe,
- ✓ Caktim i qendrës për grumbullim, trajtim dhe deponim të mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Komunat kanë raportuar për këto procese, dhe zbatimin e tyre (me afat deri në mars 2019, rrespektivisht deri në Prill 2020), në pyetësorin me kërkesat për dokumentacionin relevant për verifikim. Bazuar në këto raporte dhe më pas verifikimin e këtyre të dhënave kemi një pasqyrë të përgjithshme për realizim të proceseve në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave.

Në nivel të Kosovës, mesatarja e realizimit të proceseve, në vitin 2018 është 57%, kurse në vitin 2019 kemi një rritje të vogël dhe mesatarja e realizimit të proceseve arrin në 61.46%.

Procesi i cili nuk është realizuar nga komunat, është procesi 6, në pamundësi të kontraktimit të kompanive të licencuara për mbledhje dhe grumbullimin dhe transportin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, pasi që deri më sot asnjë kompani nuk është e licencuar. Megjithatë disa komuna kanë ndërmarrë hapa në menaxhim të kësaj kategorie të mbeturinave, duke kontraktuar kompanitë publike që operojnë në territorin e komunave, apo edhe kompani private ndërtimore apo forma tjera.



Figura 24. Niveli i plotësimit të proceseve të kërkuara në nivel vendi shprehur në %

Deponimi i mbeturinave komunale në deponitë sanitare

Sasia e mbeturinave komunale të gjeneruara dhe të deponuara në deponitë sanitare në Kosovë është gjithnjë në rritje siç vërehet edhe në figurën në vijim. Sasia më e madhe e mbeturinave është deponuar në deponinë sanitare në Mirash (Prishtinë), ndërsa sasia më e vogël në deponinë sanitare në Dragash.



Figura 25. Trendi i deponimit të mbeturinave komunale në Kosovë, 2015-2019



Figura 26: Deponimi i mbeturinave komunale në deponitë sanitare në Kosovë, 2015-2019

Në deponit sanitare të menaxhuara nga KMDK-ja: Mirashi (Prishtinë), Dumnicë (Podujevë), Velekincë (Gjilan), dhe Landovicë (Prizren), deponimi i mbeturinave në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 ka shënuar rritje pre 37437.15 ton, përkatësisht 12.5% rritje.

Ndërkaq në deponinë sanitare rajonale në Mitrovicë (Gërmovë) në vitin 2019 janë deponuar 8379.60 ton, përkatësisht 15.6 % më pak mbeturina, se në vitin 2018, kurse në deponinë sanitare në Pejë në vitin 2019 janë deponuar 3237.00 ton, përkatësisht 6.5% më shumë mbeturina krahasuar me vitin 2018.

Deponia e Dragashit dhe ajo e Podujevës janë karakteristike sepse këtu deponohen mbeturinat e gjeneruara vetëm në këto Komuna, dhe në të dy këto deponi kemi një rritje të lehtë të sasisë së mbeturinave të deponuara në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

Mbeturinat spitalore

Një spektër i mbeturinave spitalore të prodhuara nëpër qendrat spitalore në Kosovë, i nënshtrohet trajtimit përmes procesit të sterilizimit nëpër sterilizator të cilët janë të vendosur në kuadër të 8 qendrave spitalore.

Nga të dhënat e grumbulluara përmes raporteve, vërejmë se kemi rritje nga viti në vit të këtyre mbeturinave që i nënshtrohen trajtimit nëpër këto qendra (Fig.27).

Sasia më e madhe e këtyre mbeturinave edhe gjatë vitit 2019 sikurse edhe në vitet paraprake është trajtuar në impiantin i cili operon në QKUK duke u pasuar nga ai në Prizren, kurse sasia më e vogël është trajtuar në impiantin e vendosur në Vushtrri.



Figura 27: Sasia e mbeturinave spitalore të trajtuara përmes sterilizimit gjatë vitit 2015-2019

Anketa e mbeturinave të trajtuara[20]

Në këtë anketë janë përfshirë bizneset të cilat merren me trajtim të mbeturinave Në bazë të anketës së mbeturinave të trajtuara 2018 të realizuar nga ASK, u siguruan të dhëna për llojet e mbeturinave të trajtuara dhe mënyrën e trajtimit. Në figurën në vazhdim shohim se përqindja më e madhe e mbeturinave të trajtuara i takon mbeturinave të metalit, pasuar nga ato të plastikës. Format e trajtimit kanë qenë deponimi, sterilizimi, riciklimi përkatësisht ndarja dhe klasifikimi.



Figura 28: Trajtimi i mbeturinave në Kosovë

[20] *ASK, Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2018*

Mbeturinat industriale[21]

Rezultatet nga anketa e mbeturinave industriale 2018, tregojnë se gjithsej sasia e mbeturinave industriale të gjeneruara ka qenë 2.554.308 ton, ndërsa sasia e mbeturinave të dërguara diku tjetër është 945,318 ton, mbeturina të deponuara 1.567,872 ton, mbeturina të ricikluara 40.585 ton, mbeturina të djegura 1.030 ton dhe gjithsej mbeturina të përpunuara 2.554.308 ton. Ndërsa sasia më madhe e mbeturinave të gjeneruara sipas sektorëve ka qenë nga sektori D me 1. 358.598 ton (Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar, furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim i mbeturinave dhe aktivitete revitalizimi të tokës, sektori i dytë për nga gjenerimi i mbeturinave ka qenë sektori B (Xehetaria dhe guroret) me 448.754 ton.



Figura 29:. Trendi i gjenerimit dhe përpunimit të mbeturinave industriale në Kosovë 2016-2018

[21] *ASK, Anketa e Mbeturinave Industriale, 2018*

Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës

Është i njohur fakti se thasët dhe qeset e plastikes kontribuojnë shumë në sasinë e gjeneruar të mbeturinave sidomos atyre komunale, por edhe në sasinë e gjeneruar nga aktivitetet ekonomike dhe industriale. Bazuar në të dhënat e marra nga Doganat e Kosovës sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të importuar në vitin 2018 është **1,094,622.34 kg**, respektivisht **1,572,260.14 kg** në vitin 2019 kurse sasia e eksportuar është 76,239.31 kg, rrespektivisht 216,935.70 në vitin 2019.



Figura 30. Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës importuar në 2018 dhe 2019



Figura 31: Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës eksportuar në 2018 dhe 2019

Eksporti i mbeturinave

Pa dyshim se eksporti i çfarë do sasie të mbeturinave ndikon në zvogëlimin e masës së mbeturinave e cila zakonisht deponohet në deponit sanitare dhe një pjesë ngelet nëpër lokacione të pakontrolluara. Bazuar në të dhënat e ofruara nga doganat e Kosovës, në tabelën në vijim pasqyrohet situata me eksportin e mbeturinave nga Kosova për në vende të ndryshme. Zakonisht eksportin e bëjnë disa kompani që janë të organizuara në formë të bizneseve, dhe merren me grumbullimin dhe klasifikimin e mbeturinave, por eksportit i kontribuojnë edhe grupe individësh që operojnë jashtë sistemit.

Tabela 28. Eksporti i fraksioneve të ndryshme të mbeturinave

Viti	**Fraksionet e mbeturinave të eksportuara në 2018 dhe 2019**	**Neto Kg**
Eksporti 2018	Mbeturina plastike	1,969,400.00
	Gazeta dhe revista, numërator telefonik, broshura dhe materiale reklamuese të shtypura të cilat janë të vjetra dhe të pa shitura	110.00
	Mbetje te tjera te prej letrës apo kartonit të bërë kryesisht prej brumit mekanik	14,353,010.00
	Mbetje te tjera te prej letrës apo kartonit, të pa seleksionuara	4,308,261.00
	Mbetje te tjera te prej letrës apo kartonit, të seleksionuara	1,611,860.00
	Të tjera mbetje dhe kthime te tjera ferrike	104,967,449.00
Total		**127,210,090.00**
Eksporti 2019	Mbeturina plastike	1,393,788.00
	Mbetje te tjera te prej letrës apo kartonit të bërë kryesisht prej brumit mekanik	13,949,269.00
	Mbetje te tjera te prej letrës apo kartonit, të pa seleksionuara	2,829,110.00
	Mbetje te tjera te prej letrës apo kartonit, të seleksionuara	3,256,220.00
	Të tjera mbetje dhe kthime te tjera ferrike	93,042,020.00
Total		**114,470,407.00**

1.6. Gjendja në mjediset e rrezikuara

Në kuadër të këtij kapitulli do të prezantohen të dhënat për ato zona përkatësisht për ata operatorë që raportojnë në mënyrë të rregullt të dhënat e tyre në AMMK pëmes raporteve mujore dhe vjetore. Nga numri i përgjithshëm i operatoreve ndotës të cilat janë të pajisur më leje të integruar nga MMPH është gjithsejtë tetë(8), vetëm dy prej tyre janë duke raportuar për gjendjen mjedisore në lokalitetin ku operojnë (Feronikeli dhe Sharrcemi).

1.6.1. Zona e veprimit te operatorit ekonomik KEK dhe ndikimi në mjedis

KEK sh.a. është themeluar me qëllim të kryerjes së veprimtarisë të eksploatimit të qymyrit dhe gjenerimit të energjisë elektrike. KEK-u është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 2008/03-L-087- për Ndërmarrjet Publike. KEK sh.a. është ndërmarrja kryesore për prodhimin e energjisë elektrike (prodhon rreth 97 % të sasisë së përgjithshme të energjisë elektrike) të Kosovës dhe titullar i KEK-ut është Qeveria e Republikës së Kosovës. Funksionet e korporatës rregullohen përmes politikave të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës.

Struktura organizative e KEK-ut përbëhet nga këto njësi: Minierat e Qymyrit dhe Gjenerimi i Energjisë Elektrike dhe funksionon nëpërmes divizoneve që ka në përbërje të vet:

- ✓ Divizioni për prodhimin e qymyrit (DPQ),
- ✓ Divizioni i TC" Kosova A ";
- ✓ Divizioni i TC "Kosova B";
- ✓ Divizioni Shërbimet e Korporatës, në përbërje të të cilit është edhe Departamenti i Mjedisit;
- ✓ Njësitë tjera përkrahëse[22]

KEK-u gjatë eksploatimit të qymyrit në miniera sipërfaqësore dhe djegies në termocentrale pas këtij procesi pas veti lënë shumë dëme mjedisore në shumë sektorë si;

- ✓ Ndotja e ajrit si rezultat i emisioneve të shkarkuara nga TC-të.
- ✓ Ndotja e ujërave nga shkarkimet e emisioneve ndotëse nga proceset teknologjike,

[22] *Raporti i gjendjes mjedisore në KEK për vitin 2018, Departamenti i Mjedisit*

- ✓ Degradimi i tokave si rezultat i eksploatimit të qymyrit nga mihjet sipërfaqësore

Në anën tjetër procesi i vetëdjegëses së thëngjillit në sipërfaqe të mihjes sipërfaqësore, po ashtu është një problem në vete i cili gjatë tërë vitit shkarkohen emisionet ndotëse. Ndikimet mbi stabilitetin e terrenit nga shpatet e pjerrëta dhe deformimi i sipërfaqeve (rrëshqitja e tokës), Liqeni i kaltërt ku bëhen shkarkimet e hidraulikut(bartja e hirit), zhurma nga pajisjet e minierës dhe aktiviteti i shiritave transportues, etj, janë probleme mjedisorë të cilat edhe më shumë e rendojnë gjëndjen mjedisore në këtë lokalitet.

Gjatë vitit 2018/2019 në KEK janë gjeneruar mbeturina në formë të vajrave me përbërje të PBC (Bifenoleve të Polikloruara), vajra tjera mbeturinë-17800 l(2018), mbetjet radioaktive, azbest, mbeturinat metalike dhe mbetjet tjera. Në KEK ndodhën gjithësejt 31 transformator që janë të supozuar që përmbajnë vaji PCB. Në zonën Departamentit të Seperimit Kimi (DSK), gjendet bunkeri special për deponimin e përkohshëm të materieve radioactive me izotopet e Co-60 dhe është nën administrimin e Agjencionit të Kosovës për Mbrojtje nga Rrezarimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB).[23]

Disa të dhëna për ecuritë e prodhimit të energjisë elektrike gjatë viti 2018/2019

- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga TC Kosova A për vitin 2018/2019 ka qenë : 2 240 648/ 2366472 MWh.
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga TC Kosova B për vitin 2018/2019 ka qenë : 3 359 902/3670103 MWh.(në dy TC A&B kemi prodhim të energjisë elektrike me të lartë në vitin 2019)
- Totali i prodhimit të energjisë elektrike në TC A&B për vitin 2019 është 6036574 MWh, që do të thot 436024 MWh me i lartë sesa në vitin 2018.
- Shfrytëzimi i përgjithshëm i linjitit për vitin 2018/2019 nga termocentralet e KEK-ut: rreth 7576255 / 8347956 t. Ky shfrytëzim ishte me i lartë në vitin 2019 për 771701 t në krahasim me vitin 2018.
- Gjatë vitit 2018 TC Kosova A, mesatarisht ka shpenzuar rreth 1.471 t/MWh, ndersa në vitin 2019 kjo mesatare është 1.52 t/MWh. TC Kosova B në vitin 2018 mesatarisht ka shpenzuar rreth 1.27 t/MWh, ndersa ne vitin 2019 ishte 1.25 t/MWh.
- Sasia e përgjithshme e hirit të prodhuar gjatë vitit 2018/2019 për dy TC - të ka qenë rreth 1149284 dhe 1238853.2 t. Në vitin 2019 kishim 89569.2 t hiri me shumë sesa në vitin 2018. Hiri transportohet nga termocentralet deri të mihjet e Mirashit përmes sistemit hidraulik.
- Konsumi i ujit në TCA dhe TCB për vitet 2018/2019 ka qenë: 15120520 dhe 16323220 m^3, që do të thotë në vitin 2019 ishte me i lartë për 1202700 m^3.
- Sasitë e shpenzuara të naftës dhe mazutit për vitin 2018: naftë në TC Kosova A është 2387.810 litra dhe mazut në TC Kosova B ishte 4231 ton. Në vitin 2019 në TC Kosova A ishte 2132.6 litra naft dhe në TC B ishte 3134.52 ton mazut.

[23] *Raporti i Gjendjes Mjedisore në KEK për vitin 2019*

Vlerësimi i emisioneve në ajër në TC Kosova A &TC Kosova B 2018-2019

TC Kosova A dhe TC Kosova B janë dy termocentrale të cilat vlerësohet së janë ndër ndotësit më të mëdhenj në Kosovë. Termocentralet janë të ndërtuara në dy lokacionin të Komunës së Obiliqit.

KEK është kompania publike e Kosovës, e cila ka në pronë dhe operon me aset të gjenerimit të energjisë elektrike dhe të mihjes së linjitit.
Sipas Direktivës 2001/80/EC, si dhe UA nr./2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e pa lëvizshme të ndotjes me djegie të madhe, janë si me poshtë;

- ✓ ***SO_2***.....*400 mg/Nm^3*
- ✓ ***NOx***.....*500 mg/Nm^3*
- ✓ ***Pluhur***.....*50 mg/Nm^3*

Parametrat e SO_2, NOx janë kalkuluar (përveç emisionit të pluhurit i cili matet) në TC-A, ndërsa në TC-B është i instaluar Sistemi on-line(SAKME) i matjeve por aktualisht parametrat ndotës janë të kalkuluar për shkak të mosfunksionimit të SAKME).
Në vijim janë paraqitur grafikisht emisionet e Pluhurit, SO_2 dhe NOx për vitin 2018.

Emisionet e Pluhurit - Emisionet e pluhurit të shkarkuar nga TC-A të dhënat tregojnë se nuk ka pasur tejkalim gjatë muajve janar – dhjetor , ndërsa në TC-B vlerat e emituar të pluhurit janë shumë të larta, (fig. 32).



Figura 32. Emisionet e pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar - Dhjetor të vitit 2018/2019

Emisionet e SO_2- Gjatë muajve janar – dhjetor në TC A, vlerat e shkarkuar në ajër të SO_2 janë tejkaluar vlerat e lejuara sipas standardeve, ndërsa në TC B kemi tejkalime mbi vlerat e lejuara gjatë pothuajse gjatë tërë viteve 2018-2019, (fig.33).



Figura 33. Emisionet e SO_2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2018 dhe 2019

Emisionet e NOx- Për emisionet e NOx në TC-A dhe në TC-B, të dhënat tregojnë se kemi tejkalime të vlerave të lejuara gjatë dy viteve 2018/2019, (fig.34).



Figura 34. Emisionet e NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar - Dhjetor të vitit 2018 dhe 2019

1.6.2. Zona e veprimit e operatorit ekonomik Feronikelit dhe ndikimi në mjedis

Feronikeli që nga viti 2007 ka filluar prodhimin si operator privat. Nga MMPH, Feronikeli është pajisur me leje te integruar në vitin 2014. Po ashtu është i certifikuar me standardin për Menaxhim të mjedisit ISO 14001:2015 dhe Standardin për kontroll të cilësisë ISO 9001:2015.

Feronikeli prodhon një feroaliazh unik-feronikelin (Fe-Ni). Metalurgjiku furnizohet nga minierat lokale (Gllavicë dhe Çikatovë si dhe xehet e importuar nga vendet e ndryshme të botës. Ferro nikeli prodhon aliazhin Fe-Ni, që kryesisht përmban 25% Ni dhe 75 % Fe.

Gjatë procesit teknologjik shfrytëzohen lënde të para, lëndë ndihmës dhe lënde djegëse, të cilat më pastaj lirohen emisione ndotëse në ajër.

Përpos emisioneve në ajër, kemi shkarkime edhe të emisioneve ndotëse veçanërisht nga deponia e skories. Në aspektin kimike skorja ka përmbamje nga; SiO_2, Fe, MgO, CaO, Cr_2O_3, Al_2O_3, Ni. Mbetje tjera të gjeneruara nga Feronikeli janë; vaj i përdorur 1500l, shirita dhe goma të përdorur 8 t, etj.[24]

Në përgjithësi niveli i menaxhimit mjedisorë në Feronikel akoma kërkon përmirësime të nevojshme duke vlerësuar se emisionet e liruara nga procesi teknologjik janë si në uji ashtu edhe në ajër, nga ky operator janë ndotës me metale të renda. Përmbajtja e metaleve të rënda në xehen fillestare, si Fe, Ni, Co, Cd, Cr, As, Pb etj. dhe proceset metalurgjike që e shoqërojnë procesin e tërësishëm e karakterizojnë Feronikelin ndotës se kategorisë A (sipas Kritereve për VNM-BEZH dhe BB).

Lënda e parë, lëndët djegëse dhe lëndët ndihmëse që janë përdor në Feronikel gjatë viti 2018 dhe mbetjet e gjeneruara:

2018

Xehe: 460693 të linjit: 65247 të qymyrguri: 908 të koks: 0 të guri gëlqeror: 13676 të oksigjen i lëngët: 341 të oksigjen i gaztë: 4784 të energji elektrike : 219511 MWh; mazut : 3526 të petkos: 17086 të ujë teknologjik : 1388474 m^3. etj.

Gjatë vitit 2018 janë gjeneruar dhe deponuar në deponinë e skorjes në Sukë: 297214 t skorje.

2019

Xehe: 768083 të linjit: 114723 të qymyrguri: 995 të koks: 0 të guri gëlqeror: 23570të oksigjen i lëngët: 819 të oksigjen i gaztë: 7239 të energji elektrike : 371088 MWh; mazut : 5214 të petkos: 29541 të ujë teknologjik : 1551320 m^3. etj.

Gjatë vitit 2019 janë gjeneruar dhe deponuar në deponinë e skorjes në Sukë dhe deponin e Dushkajës: 491890 t skorje.

[24] *Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Feronikel për vitin 2018*

Vlerësimi i emisioneve në ajër në Feronikel 2018-2019

Feronikeli gjatë procesit të prodhimit liron emisionet ndotëse si në ajër. Emisionet ne ajër rrjedhin veçanërisht nga furrat rrotulluese, furrat elektrike, konvertori dhe ngrohtorja.

Tabela 29: Vlerat kufitare të emisionit (VKE) sipas UA 06/2007 dhe "Lejes Mjedisore të Integruar" për Feronikelin

Substancat ndotëse	Vlera (mg/Nm3)
Pluhuri	30
CO	1000
SO2	600
NOx (NO2)	350

Më poshtë janë të paraqitur në mënyrë grafike emisionet e Pluhurit, SO_2 dhe NOx të matura në feronikel, gjegjësisht në:

- ✓ Oxhakun e furrave rrotulluese;
- ✓ Oxhaku e konvertorëve;
- ✓ Furra elektrike nr.1. pas skruberit;

Gjatë muajve prill-korrik, 2018, nuk ka pasur monitorim për shkak së fabrika ka qenë jashtë procesit të prodhimit. Matjet e emisioneve në Feronikel i bënë laboratori i licencuar "Teknolab" nga Shkupi (Maqedonia e Veriut).

Oxhaku i Furrave Rrotulluese

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në Furrën rrotulluese- Vlerat mesatare mujore të pluhurit gjatë viteve 2018/2019 nuk kanë pasur tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara, (fig.35).



Figura 35. Vlerat mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në Furrën rrotulluese Janar - Dhjetor 2018/2019

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të CO në Furrën rrotulluese- mesatare mujore të CO sipas vlerësimeve të dhënave tregojnë se nuk ka tejkalime nga vlerat e lejuar kufitare gjatë viteve 2018/2019, (fig.36).



Figura 36. Vlerat mesatare mujore e emisioneve të CO në Furrën rrotulluese Janar – Dhjetor, 2018/2019

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të SO_2 në furrën rrotulluese- vlerat mesatare mujore të SO_2 për vitet 2018-2019, nuk i kanë tejkaluar vlerat kufitare të lejuara, (fig.37).



Figura 37: Vlerat mesatare mujore të emisioneve të SO2 te Furrat rrotulluese Janar - Dhjetor 2018/2019

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të NO_2 në Furrën rrotulluese- Vlerat mesatare mujore të NO_2 tregojnë se nuk ka tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara për vitet 2018/2019, shih fig.38.



Figura 38: Vlerat mesatare mujore e emisioneve të NO2 në Furrën rrotulluese Janar - Dhjetor 2018/2019.

Oxhaku i konvertorit

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të Pluhurit në Konvertor- Vlerat mesatare mujore të emisioneve të pluhurit në Konvertor nuk ka tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara gjatë viteve 2018/2019, (fig.39).



Figura 39: Vlerat mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në Konvertor, Janar - Dhjetor 2018/2019

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të CO në Konvertor- mesatare mujore CO sipas të dhënave tregojnë se gjatë vitit 2018/2019, nuk kemi pasur tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara, (fig.40).



Figura 40: Vlerat mesatare mujore e emisioneve të CO në Konvertor Janar - Dhjetor 2018/2019.

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të SO_2 në konvertor- Vlerat mesatare mujore të SO_2 në konvertor gjatë viteve 2018/2019, të dhënat tregojnë se nuk kemi tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara, (fig.41).



Figura 41: Vlerat mesatare mujore e emisioneve të SO2 në Konvertor Janar - Dhjetor 2018/2019

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të NO_2 në Konvertor- Vlerat mesatare mujore të NO_2 në konvertor tregojnë së për vitet 2018/2019, nuk kemi pasur tejkalime mbi vlerat kufitare të lejuara, (fig. 42).



Figura 42: Vlerat mesatare mujore e emisioneve të NO2 në Konvertor Janar - Dhjetor 2018/2019

Furra elektrike nr.1 pas skruberit

Vlerat mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në Furrën elektrike nr.1 pas skruberit- Vlerat mesatare të pluhurit në Furrën elektrike nr.1 pas Skruberit, tregojnë së për vitet 2018 dhe 2019, nuk ka tejkalime mbi vlerat e lejuara. Gjatë muajve prill, maj, qershor dhe korrik 2018, nuk ka pasur matje (fig.43).



Fig.43. Vlerat mesatare mujore e emisioneve të Pluhurit në Furrën elektrike 1 pas skruberit Janar - Dhjetor 2018/2019

1.6.3. Zona e operatorit ekonomik SharCemit dhe ndikimi në mjedis

SharrCemit operon nën kushtet e lejes se Integruar (IPPC) qe nga viti 2014. Kompania që nga viti 2013, operon më një sistem të monitorimit të vazhdueshëm te emisioneve (CEMS). Impianti për trajtimin e ujërave te zeza është ne funksion te plote qe nga marsi i vitit 2016. Nga ky impiant për vitin 2018/2019 janë trajtuar 80760 m^3/uji. Në nëntor të 2017, sharrcem-i adapton dhe zhvillon sistemin e menaxhimit të mjedisit me standardin më të ri, iso 14001:2015. Ky standard është ri certifikuar në nëntor 2019.

Emetimet në ajër si pluhuri, Oxidet e Squfurit(SOx) dhe oxsidet e azotit (NOx), janë shumë më te ulëta se sa kufijtë e lejuar të përcaktuar në rregulloret dhe standardet e Kosovës dhe të BE-së.
Rehabilitimi i minierës së Dimcës ka filluar në vitin 2015 me rehabilitimin teknik rimbushjen e etazhes E-480 me, gjatë vitit 2016 plani i rehabilitimit ka vazhduar se implementuari në etazhën e dytë E-470 dhe në vitin 2018, është bërë edhe rehabilitimin teknik i etazhes se tretë E-460.

Plani i rehabilitimit të minierës së mergelës ka vazhduar edhe në vitin 2019 në etazhën e tretë E-450 si rehabilitim teknik dhe mbjelljen e 300 fidaneve.
Në kuadër të plan programit gjate vitit 2018/2019 ju referohet aktiviteteve për mbylljen e plotë të depos se klinkerit dhe instalimin e një filteri te ri ne hinkën pranuese te shkarkimit te klinkerit ne depon e klinkerit dhe reduktimin e zhurmave ne mjedis nga ventilatorët e furrës. Kjo problematik është mbyllur në vitin 2019 sipas Planit të Veprimit të Sharcemit. [25]

Mbeturinat varësisht prej llojit barten dhe largohen nga nënkontraktohet e licencuar si dhe të autorizuar nga operatori. Varësisht nga lloji i mbeturinave janë të kufizuara dhe ruajtura ne hapësira te veçanta me qellim te shmangies së rrjedhjes në ujë dhe tokë. Këta nënkontraktorë ofrojnë shërbime lidhur me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.[26]

Treguesit kryesor për vitin 2018-2019

Prodhimi i klinkerit: 882.231 t/vit: Prodhimi i cimentos: 1453106 t/vit

[25] *Raporti vjetor për mjedis, Sharrcemi, 2019*
[26] *Raporti vjetor për mjedis, Sharrcemi, 2018*

Vlerësimi i emisioneve në ajër në SharrCem 2018-2019

Në vijim janë paraqitur në mënyrë grafike emisionet e pluhurit, SO_2 dhe NOx në SharrCem.

Emisionet e pluhurit -Për emisionet e pluhurit janë paraqitur te dhënat nga furra e mullirit të lëndës së parë për vitin 2018/2019, dhe sipas vlerësimeve vlerat janë shumë të ulëta në krahasim me vlerën kufitare të emisioneve (VKE). (fig. 44).



Fig.44. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit te furra – mulliri i lëndës së parë, 2018/2019

Vlerat e emisioneve te pluhurit te ftohësi i klinkerit vlera e emisioneve të pluhurit për vitet 20182019, janë shumë të ulëta në krahasim me vlerën e lejuar sipas standardeve të kërkuara (fig.45).



Fig. 45. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit te ftohësi i klinkerit dhe të mulliri i cimentos, 2018/2019

Emisionet e SO_2-Për emisionet e SO_2 janë paraqitur te dhënat nga matja e emisioneve te furra (mulliri i lëndës së parë).



Fig.46. Vlera mesatare mujore e emisioneve të SO_2, 2018/2019.

Emisionet e SO_2 të shkarkuara gjatë procesit të prodhimit në SharrCem, të dhënat tregojnë se vlerat janë shumë të ulëta dhe sipas standardeve të kërkuara. (fig.49.)

Emisionet e NOx-Për emisionet e NO_x janë paraqitur te dhënat nga matja e emisioneve te furra (mulliri i lëndës së parë).



Fig.47. Vlera mesatare mujore e emisioneve të NOx, 2018/2019.

Emisionet e shkarkuara në ajër të NOx në SharrCem, nuk i kanë tejkaluar vlerat e lejuara sipas standardeve të kërkuara, gjatë gjithë procesit të prodhimit në vitet 2018/2019 (fig.47).

1.7. Shëndeti publik

Ndotja e mjedisit me theks të veçantë ndotja e ajrit dhe ujit janë faktor që ndikojnë direkt në shëndetin e njeriut. Ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit dhe ujit llogaritet si shkaktar i shumë sëmundjeve dhe vdekjeve të parakohshme. Ndotja e ajrit edhe pse mund të mos jetë shumë e dukshme vizualisht, ajo mund të jetë vdekjeprurëse për shkak të përmbajtjes toksike që kanë. Në përgjithësi ajri në zonat urbane e në veçanti në Prishtinë, Obiliq, është vlerësuar së është shumëfish më i ndotur se normat e lejuara.
Një ndër ndotësit me të mëdhenj në Kosovë janë vlerësuar industria energjetike, industria metalurgjike, minierat, depozite minerare, industriale dhe urbane, deponit ilegale te mbeturinave, transporti, bujqësia etj.
Shkarkimet e emisioneve ndotëse në ajër dhe ujëra jo vetëm që shkaktojnë probleme të shumta mjedisore, por në rast të kontaktit me njerëz shkaktojnë probleme të shumta në shëndet. Ndotësit e tillë lënë pasoja në shëndet duke shfaq sëmundjet e sistemit kardiovaskular, ulje të kapacitetit funksional të mushkërive të përcjella me infeksione dhe përkeqësim të astmës, diare, kancerin e mushkërive, dëmtimeve gjenetike që shoqërohet me a-normalitet qelizore, mutacionet qelizore dhe çrregullimet tjera qelizore.
Gjatë shekullit 21 është rritur në masë të konsiderueshëm nevoja për të evidentuar faktorët që po shkaktojnë sëmundjet kronike, siç janë: diabeti, zhvillimi neurologjik i fëmijëve, sëmundjet që lidhen me stresin etj. Të gjitha këto sëmundje kanë një lidhshmëri më mjedisin në të cilin jetojmë dhe mënyrën se si e ruajmë dhe menaxhojmë atë. Duke u mbështetur në raporte të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për çdo vit më shumë se dy milionë vdekje të parakohshme mund t'i atribuohen ndotjes së ajrit si rezultat i djegies dhe lirimit të gazrave të ndryshëm, vdekje tjera që vijnë si pasojë e ujit të ndotur, tokës dhe ndotjeve tjera. Andaj, faktori njeri ka një rrol vendimtar në të gjitha këto procese që më aktivitetet e tij mund të ndikojë në zvogëlimin e këtyre ndotësve që janë më pasoja për shëndetin e njeriut.
Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) e bën monitorimin e gjendjes së shëndetit publik e në veçanti përcjelljen e sëmundjeve të shkaktuara nga epidemitë dhe pandemitë, lëndimet në punë, në komunikacion apo gjetiu, masat mbrojtëse, promovim dhe nxitjen e sjelljeve të shëndosha ndaj jetës dhe mjedisit.
IKSHP si institucion për monitorim dhe prevenim të sëmundjeve ambientale, ka zhvilluar një sistem të informimit shëndetësor për publikun me te dhënat ndër vite për sëmundjet ambientale të cilat paraqiten për arsye të shume faktorëve: ekologjik, socio-ekonomik, mos informimi, ndryshimet klimatike.

Në tabelen nr.29 janë paraqitur trendi i sëmundjeve ambientale për vitet 2018-2019. Në krahasim me listën e sëmundjeve të vitit 2018, ne vitin 2019 listes i u janë shtuar edhe 10 semundje ambientale.
Në vitin 2019 semundjet ambientale me numër me të madh janë; Sëmundjet e ngjajshme me gripin (ILI), Influencat A, Diarre akute, Varicela, Sindromi meningjeal, Leishmaniasis, Intoxicatio alimentaris, Adenovirusis, Sallmonelosis, Shigelloza, Rotavirus, Leptospirosis, E coli patogjen, Ethet Q, Gastroenterokolitet, IST, Parazitozat, Status post ictus ixodes, Status post morsum coni dhe Status post morsum viperi. Ndersa sëmundjet tjera ambientale ishin me te larta gjatë vitit 2018.

Tabela 29: Sëmundjet ambientale 2018 dhe 2019

Sëmundjet	2018		2019	
	Rastet	Mbi 100000 banor	Rastet	Mbi 100000 banor
ITPR-Pneumonia/ARI	12607	689.95	12284	672.27
SARI (Formë e rënd e pneumonisë)	72	3.94	63	3.45
Semundje e ngjashme me gripin (ILI)	75643	4139.76	79952	4375.58
Influenca A	0	0	386	21.1
Influenca A pdm09	0	0	71	3.9
Diarreja akute	75492	4131.50	87635	4796.05
Varicela	7327	400.99	12600	689.57
Sindromi i diarresë me gjak	36	1.97	35	1.92
Sindromi meningjeal	124	6.79	195	10.67
EHKK	1	0.05	1	0.5
EHSV	4	0.22	3	0.16
Ëest Nile virus	14	0.77	0	0
Sëmundja e lajmit	3	0.1	0	0
Leishmaniasis	0	0	6	0.30
Malaria	3	0.16	3	0.16
Legionellosis	0	0	1	0.05
Sindrome me ethe ekzantematike	83	4.54	0	0
Pertussis	22	1.20	17	0.93
Ethe tifoide	0	0	1	0.10
Parotiti epidemik	92	5.03	63	3.45
TBC	700	38.31	-	-
Intoxicatio alimentaris	1896	103.76	2394	131.02
Verdhëza akute A	77	4.21	44	2.68
Verdhëza B	80	4.38	36	1.97
Verdhëza C	11	0.60	11	0.60
Typhus abdominalis	2	0.11	0	0
Adenovirosis	11	0.60	35	1.92
Sallmonelosis	99	5.42	134	7.33
Shigelloza	0	0	32	1.75
Rota virus	191	10.45	271	14.83
Tularemia	19	1.04	12	0.66
Lymphadenitis	0	0	0	
Leptospirosis	2	0.11	4	0.22
Morbili	195	10,67	16	0.87
E.coli patogjene	18	0,99	22	1.20
Bruceloza	28	1.53	13	0.71
Echinoccocosis	2	0.11	0	0.00
Toxoplasmosis	9	0.49	8	0.44

Ethet Q	0	0	1	0.05
Giardia sis	3	0.1	0	0.00
Yersinia enterocolitica	1	0.05	0	0.00
Gastroenterokolitet	0	0	379	20.74
Lymphadenitis ac.coli	102	5.58	49	2.68
Campylobacter	0	0	0	0
IST	1155	63,21	1321	67.10
Parazitozat	0	0	141	7.72
Giardiasis	3	0.16	0	0.00
Status post ictus ixodes	0	00	109	6.00
Status post morsum cani	0	0	3	0.16
Status post morsum viperi	0	0	19	1.04
Sëmundjet tjera ngjitëse	643	35.19	503	27.53
Total	176767	9674.04	198882	10884.34

Sëmundjet ambientale paraqiten si pasojë e higjienës së dobët, kushteve socio-ekonomike, furnizimit me ujë të pijes nga burimet e pakontrolluara-puset, ndërprerja e gjatë e ujit nga ujësjellësi, ujërat e ndotura, mungesa e kanalizimit, hedhja e mbeturinave afër burimeve të ujit dhe ndotës tjerë.

Probabiliteti për shfaqjen e shumë sëmundjeve është më i madh gjatë stinës së verës, për shkak se në këtë periudhë kohore temperaturat janë më të larta, duke krijuar kushte më të favorshme për përhapjen e viruseve dhe baktereve. Në të njëjtën periudhë kohore, kushtet higjeno sanitare në disa vise të Kosovës janë në nivel më të ulët si rezultat e mungesës së ujit dhe thatësisë.

Cilësia e ujit të pijes

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Kosova ka një legjislacion të mirë për mbrojtjen e ujërave për pije. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2017, janë ndër udhëzimet me me rendësi për mbrojtën e ujërave të pijshëm dhe të cilat janë në përputhje me standardet e BE- së, për ujin e pijshëm.

KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor për konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Nga ana tjetër IKSHPK, është institucion me përgjegjësinë ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm në tërë territorin e vendit. IKSHPK siguron se uji i distribuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendore për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik. Në këtë raport vlerësimi i cilësisë është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga QU në ARRU.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të kryer nga Qendra e Ujit e Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK) konform përgjegjësive që ka, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, rezulton se gjatë viteve 2018/2019, ka qenë ne përputhje me standardet e ujit të pijshëm. Gjatë vitit 2018, janë marrë 8,598 mostra të ujit në rubinetet e konsumatorëve me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik, në të cilën 99.4% të mostrave kanë qenë në përputhshmëri me standardet e kërkuara. Ndërsa në vitin 2019 janë marrë 9,229 mostra të ujit nga rubinetet e me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik (fig.48). Nga totali i mostrave të marrur për testim 98.8% të tyre kanë qenë në përputhje me standardet vendore të cilësisë se ujit. Duke u referuara nga këto statistika, vlerësohet se cilësia e ujit e furnizuar nga KRU është në nivel shumë të mire.



Figura 48. Perputhshmeria e testeve për uji të pijes sipas standardeve vendore për parametrat bakteriologjike dhe kimike (KRU-te, 2018/2019)

Siç mund të shihet nga tabelën 30, gjatë vitit 2018 përputhshmëria më e lartë sa i përket vlerave të parametrave mikrobiologjikë ka qenë në KRU Prishtina 100%, ndërkaq përputhshmëria më e ulët në KRU Bifurkacioni 97,1%. Në vitin 2019, gjendja e përputhshmërisë me lartë për parametrat mikrobiologjik ishte në KRU Prishtina, Hidroregjioni Jugor, Gjakova me 100%, ndërsa me e ultë ishte në KRU Bifurkacioni me 95.5%, që kishte ramje prej 1.6% në krahasim me vitin paraprak.

2.

Tabela 30: Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-2018/2019

Kompanitë	Viti	KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU-Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava	Mesatare e sektorit
Mikrobiologjike	2018	100%	99.7%	98.7%	99.6%	99.7%	97.1%	98.3%	99.3%
	2019	100.0%	100.0%	99.3%	99.5%	100.0%	95.5%	96.9%	**99.2%**

Fiziko-Kimike	2018	98.9%	99.4%	100%	100%	100%	98.2%	99.4%	99.5%
	2019	99.8%	100.0%	100.0%	97.6%	100.0%	91.7%	92.1%	**97.9%**
Mesatarja për KRU	**2018**	99.7%	99.6%	99.1%	99.7%	99.8%	97.4%	98.8%	99.4%
	2019	**99.9%**	**100.0%**	**99.5%**	**99.1%**	**100.0%**	**94.5%**	**94.9%**	**98.8%**

Nga KRU Hidormorava dhe Bifurkacioni, është një furnizim me cilësi me të ultë me uji të pijes si në aspektin bakteriologjik ashtu edhe në aspektin fiziko-kimik, për shkakun e mungesës së furnizimit të rregullt me ujë të pijes.

Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujësjellës gjatë ketyre viteve sipas ARRU arrin shkallën prej 75%, ndersa mbulueshmeria me sherbime të ujërave të ndotura arrinë shkallën prej 65 %. KRU Prishtina, Gjakova dhe Hidrodrini, kanë arritur mbulueshmëri të lartë të popullatës me shërbime në kuadër të zonave të tyre respektive të shërbimeve.

Në kuadër të angazhimit të mëtejmë për të përmirësuar aspektin e sigurisë së cilësisë së ujit, ofruar konsumatorëve dhe popullatës, IKSHPK, është duke u angazhuar për avancimin, gjegjësisht azhurnimin e UA 16/2012, në frymën e kërkesave të fundit të Direktivës Evropiane dhe Rekomandimeve të OBSH.

1.8. Shfrytëzimi i resurseve natyrore

Shfrytëzimi i ujërave për pije dhe për amvisëri

Sa i përket shfrytëzimit të ujërave për pije dhe amvisëri, operojnë shtatë kompani regjionale të ujit (KRU) të licencuara nga Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit (ARRU) që ofrojnë këto shërbime si dhe 30 komuna që përfitojnë nga shërbimet e këtyre kompanive. Prodhimi total i ujit të distribuar nga kompanitë regjionale për vitin 2018 ka qenë 153,7milion m3. Më tepër se gjysma e këtij uji merret nga burimet sipërfaqsore ndërsa më pak nga burimet nëntokësore (tab. 31).

Tabela 31. Burimet e furnizimit me ujë, sasia ditore dhe vjetore (m3)

Nr	Vendmarrja e ujit	Sasia e ujit e shfrytëzuar në (m^3/ditë)	Sasia e ujit e shfrytëzuar në (m^3/vit)	Vlera e shprehur në përqindje %
1	Burim natyrorë	111,295	40,622,816	26%
2	Rezervuar	-	-	-
3	Lum	21,007	7,667,697	5%
4	Liqe	246,030	89,800,920	58%
5	Pus	43,575	15,904,983	10%
TOTAL			**153,748,772m^3**	

Prej sasisë së përgjithshme të ujit të prodhuara nga KRU 66,2 milion m^3 ujë u janë faturuar konsumatorëve, ndërsa sasia tjetër 87,5milion m^3 është ujë i cili nuk është faturuar (duke përfshirë edhe humbje teknike dhe administrative).

Shfrytëzimi i ujit për nevoja industriale

Një kategori tjetër dhe njëherit më e madhja e shfrytëzimit të resurseve ujore është përdorimi për nevoja industriale. Shpenzuesit më të mëdhenjë janë ndërmarrjet e mëdha industriale KEK-u, New Co FERRONIKEL-i, Sharrcem etj. Pjesa më e madhe e tyre furnizohen me ujë nga liqenet akumulues sipërfaqësor (tabela 33).

Tabela 32. Shpenzimet e ujit për vitin 2018-2019 nga ndërmarrjet e mëdha industriale

Shfrytëzuesit	Sasia e hargjuar m3/vit 2018	Sasia e hargjuar m3/vit 2019
KEK	15120520	16323220
New Co FERRONIKEL	1388474	1551320
SHARRCEM	137968	103302

Shfrytëzimi i ujërave për hidronergjetikë

Dihet se vendi jonë ka kapacitete të plota për prodhim të energjisë. Pas KEK-ut që është burimi kryesor i prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike , burim tjetër po aq i rëndësishëm janë hidrocentralet. Ndërtimi, jetëgjatësia dhe funksionimi i tyre paraqesin një element me rëndësi në shfrytëzimin e resurseve ujore.

Zhvillimi i një programi për rritjen e kapaciteteve të prodhimit të energjisë nga hidrocentralet është pjesë e politikës energjetike të strategjisë së energjisë së Kosovës. Kapacitetet aktuale të instaluara të hidrocentraleve në Kosovë janë 97.74 MW kurse ato operative 160.51 (tabela 33).

Tabela 33. Kapacitetet operative dhe të instaluara të hidrocentraleve[27]

Emri i hidrocentralit	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e instaluar në MW	Neto operative MW
Ujamani	1981	35	32
HC Lumbardhi 1	1957/2005	8.08	8.00
HC Lumbardhi 2		5.4	5.20
EGU Belaja	2015	8.08	7.50
EGU Decani	2015	9.81	9.50
HC Kaskada e Lumbardhit		31.37	30.20
Radavci	1934/2011		0.90
HC Burimi			0.85
HC Dikanci			3.34
HC Brodi 1			2.48
HC Brodi 2	2015		5.00

[27] *ZRRE 2020, Bilanci i Energjisë Elektrike dhe Termike*

HC Brodi 3			4.70
HC Restelica 1 dhe 2	2015		2.40
HC Restelica 3			2.35
HC Hydroline Albaniku I	2015		1.87
Hydroline Albaniku II	2015		3.55
Hydroline Albaniku III			4.22
Hidroenergji Lepenci 3			10.00
HC Brezovica (Matkos grup)			2.10
HC Binqa (EKO Energji)			0.60
HC Sharri			6.45
HC Vica			4.60
HC Shterpca			5.30
HC Dragashi Renelaul Tahiri SHPK			3.40
HC Orqusha Dragashi Renelaul Tahiri SHPK			4.00
Total		**97.74**	**160.51**

Ndërtimi dhe funksionalizimi i burimeve të prodhimit të energjisë nga hidrocentralet ka qenë pjesë e një debati të përgjithshëm gjatë viteve të fundit për shkak të problemeve me ndertimin e hidrocentraleve në zonat e mbrojtura të natyrës, procesin e lëshimit të lejeve përkatëse ujore dhe mjedisore si dhe për shkak të problemeve në zbatimin e kërkesave të këtyre lejeve.

Shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerale

Formë tjetër e shpeshtë e shfrytëzimit të resurseve natyrore është shfrytëzimi i gurit, zhavorit dhe resurseve tjera minerare përmes seperacioneve. Sipas të dhënave të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale rezulton që ky institucion vetëm gjatë periudhës 2015-2018 ka lëshuar 562 licenca për gurthyes dhe nxjerrje të rërës dhe zhavorrit. Prej tyre 268 janë dhënë për hulumtim dhe 294 për shfrytëzim. Nga 562 licenca 75 janë dhënë për rërë dhe zhavorr, ndërsa 487 licenca janë dhënë për gurthyes. Komunat në të cilat janë dhënë më së shumti licenca për gurthyes janë Malisheva(43 licenca), Klina(38 licenca), Kaçaniku dhe Lipjani me nga 35 licenca. Ndërsa komunat në të cilat janë dhënë më së shumti licenca për rërë dhe zhavorr janë Peja (29 licenca), Gjakova (14 licenca), dhe Kamenica (7 licenca). Vetëm gjatë vitit 2018 kanë qenë aktive 357 licenca për këtë veprimtari, nga të cilat 45 licenca për nxjerrje të rërës dhe zhavorrit.

Agjencia për Mbrotjen e Mjedisit të Kosovës, ka bërë një vlerësim të gjendjes lidhur me shfrytëzimin e resurseve minerare dhe ndër problemet kryesore që janë evidentuar në këtë sektorë janë:

- Raportet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për operatorët që aplikojnë për tu pajisur me leje mjedisore, zakonisht janë sipërfaqësore dhe nuk janë të bazuara në studime, analiza dhe matje paraprake për të identifikuar ndikimet potenciale në mjedis.
- Operimi i tyre pa u pajisur me Leje Mjedisore, dhe duke u bazuar vetëm në Pëlqime Mjedisore, që është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit;

- Lëshimi i lejeve dhe pëlqimeve mjedisore për operim të operatorëve që eksportojnë resursve minerare në zonat e mbrojtura të natyrës në kundërshtim me Ligjin e VNM dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës;
- Mungesa e monitorimit të gjendjes së mjedisit nga operatorët në zonën e operimit të tyre që po ashtu është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Mungesa e raportimit të parametrave të monitoruar nga operatori në institucionin përgjegjës, përkatësisht në MEA/AMMK.
- Mungesa e rehabilitimit dhe kthimit në gjendjen e mëparshme të zonave të shfrytëzuara nga operatorët ekonomik. Hendeqet, puset dhe akumulimet ujore të krijuara si pasojë e shfrytëzimit dhe mos rehabilitimit të zonës kanë rezultuar shpeshherë edhe me raste të vdekjeve.
- Mbikëqyrja jo efikase e punës së operatorëve dhe zbatimi i kushteve të lejeve dhe pëlqimeve për shkak të numrit të vogël të inspektorëve të mjedisit në nivel qendror dhe lokal.
- Shfrytëzimi pa kriter dhe egër i shkëmbinjve gëlqeror dhe resursve tjera minerare nga operatoret ekomomik duke mos i respektuar kriteret e parapara me lejet mjedisore.
- Përdorimi i madhe i sasisë së lëndës plasëse gjatë procesit të minimit dhe mos zbatimi i masave të sigurisë në zonën e minimit.
- Koordinimi dhe bashkëpunimi jo i mjaftueshëm i institucioneve relevante që janë pjesë e leje dhënies dhe kontrollit të zbatimit të lejeve (MEA, APK, KPMM, Komunat etj).

Ndërsa, sipas një hulumti nga Organizata Preportr, janë evidentuar 495 raste ilegale të operimit gjatë viteve 2009-2018, ku prej tyre 166 raste janë për nxjerrje të gurit të fortë, ndërsa 329 raste janë evidentuar të nxjerrjes ilegale të rërës dhe zhavorrit. Nga këto raste 357 prej tyre janë kompani, ndërsa 138 janë individë.

Nga 495 rastet ilegale të evidentuara, 297 janë në gjykatë dhe një është rast i mbyllur. Komunat në të cilat janë identifikuar më së shumti raste ilegale për gurthyes janë Gjakova (17 raste), Peja (13 raste), dhe Kaçaniku me 13 raste. Ndërsa komunat në të cilat janë identifikuar më së shumti raste ilegale për rërë dhe zhavorr janë Peja (51 raste), Kamenica (37 raste), dhe Gjakova (71 raste)[28].

Nxjerrja e rërës dhe zhavorrit pa kontrolle dhe pa kriter, ka degraduar mijëra hektarë të shtretërve të lumenjve si dhe kanë ndryshuar edhe rrjedhën natyrale të këtyre lumenjve. Ndër lumenjët më të degraduar radhiten Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Ereniku, Ibri etj, ku si pasojë gjithmonë ekziston rreziku për vërshime dhe fatkeqësi tjera natyrore.

[28] *Industria e Shkatërrimit/Preport (http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Industria-e-shkaterrimit-292)*

Shfrytezimi i resursve pyjore

Sipas të dhënave që na ofron Agjencioni Pyjor i Kosovës, gjatë vitit 2018 janë shfrytëzuar gjithsej 183,381.81m3 dru ku prej tyre 28,547.68 m3 nga sektori publik dhe 154,834.24 m3 nga sektori privat. Ndërsa gjatë vitit 2019 janë shfrytëzuar gjithsej 179,745.38 m3 dru ku prej tyre 24,486.42 m3 nga sektori publik dhe 155,253.96 m3 nga sektori privat. Nuk ka të dhëna të detajuara për prerjet ilegale. Në tabelën 34 është prezantuar shfrytëzimi i masës drunore sipas sektorëve.

Tabela 34. Sasia e masës drunore të shfrytëzuar për vitet 2018 -2019 sipas sektorëve[29]

Viti	Sektori	Sasia e masës drunore m3	Totali i masës drunore m3
2018	Sektori publik	28,547.68	183,381.81
	Sektori privat	154,834.24	
2019	Sektori publik	24,486.42	179,745.38
	Sektori privat	155,253.96	

[29] *Agjencioni Pyjor i Kosovës*

2. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit

2.1. Niveli i Zbatimit të Strategjive dhe Planeve Mjedisore

Kosova e ka në masë të kënaqshme të zhvilluar kornizën strategjike dhe programore për mjedisin dhe sektorët e tij, mirëpo niveli i zbatimit është ende në shkallë të ulët. Në tabelën 35, janë prezantuar dokumentet kryesore strategjike dhe programore të sektorit të mjedisit dhe niveli i zbatimit të tyre.

Tabela 35: Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Niveli i zbatimit
Strategjia Mjedisore e Kosovës dhe Plani Kombëtar i Veprimit Mjedisorë	2013-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Vendimi Nr. 05/140 Datë 17.07.2013	Nuk ka filluar së zbaturi për shkak të paqartësisë në procesin e aporvimit
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet	2011-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Aktualisht është në proces të rishikimit)	Pjesërisht
Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit	2018-2020	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Në fazën fillestare të zbatimit
Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	Ne proces te rishikimit	Në proces të rishikimit	Në proces të rishikimit
Strategjia dhe Plani Veprimit për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2017-2026	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Vendimi, Nr. 05/90, datë 19.02.2019	Në fazën fillestare të zbatimit
Strategjia Shtetërore e Ujërave	2017-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2018	Zbatimi në fazën fillestare
Plani Hapësinor i Kosovës-Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës	2010-2020+	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht - në proces të implementimit harta zonale e Kosovës
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht – në proces të aprovimit

			edhe dy plane rregulluese
Plani Hapësinore për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës"	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Nuk ka filluar zbatimi në mungesë të organit menaxhues për këtë zonë të mbrojtur
Plani Hapësinorë për Zonën e mbrojtur me Interes të veçantë "Beteja e Koshares"	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Hapësinorë për Zonën e me Interes të veçantë "Shtabi i përgjithshëm i UÇK-se, Kleçkë dhe Divjakë"	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Hapësinorë për Zonën e me Interes të veçantë "Fusha e Mihjes së re"	2010-2020	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar "Sharri"	2015-2024	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Pjesërisht

2.2. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale

Ndër zhvillimet kryesore në forcimin, afirmimin dhe ngritjen e kapaciteteve teknike të institucioneve mjedisore duhen veçuar:

- Themelimin dhe funksionalizimi i Autoritetit Rejonal të Pellgjeve Lumore;
- Themelimi i zyrës së Koordinatorit Nacional për Ndryshime Klimatike;
- Themelimi i Task Forcës ndërministrore për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Themelimi i komitetit drejtues për Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave;
- Rritja e numrit të personave fizik të licencuar për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
- Rritja e përfaqësimit dhe anëtarësimit të institucioneve mjedisore të Kosovës në organizata, iniciativa dhe projekte rajonale.
- Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i treguesve për raportimin dhe monitorimin të përformacës së Komunave të Kosovës për sektorin e mbeturinave.
- Vazhdimi i punës në identifikimin e burimeve të ndotësve të ajrit në regjionin e Prishtinës,
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve mjedisore përmes trajnimeve dhe programeve në nivelin nacional, regjional dhe ndërkombëtarë;

Ndërsa, në kuadër të ngecjeve dhe pengesave në forcimin e institucioneve mjedisore gjatë kësaj periudhe veçohen:

- Mungesa e rrjetit për monitorimi e ujerave nëntokësore;
- Mungesa e monitorimit të aspekteve biologjike/ekologjike të ujërave sipërfaqësore;
- Mungesa e një sektori të veçantë për Ndryshime Klimatike në MMPH;
- Mungesa e një institucioni të veçantë në nivel qendror për monitorimin e kimikateve;
- Numri i vogël i programeve edukative të nivelit bachellor dhe master në fushën e mjedisit;
- Numri i vogël i stafit në sektorin e natyrës e sidomos ne Institutin e Mbrojtjes se Natyrës;
- Mos funksionalizimi i Bordit Këshilldhënës për Mjedisin;
- Largimi i stafit të trajnuar dhe më përvojë nga institucionet përgjegjëse të sektorit të mjedisit.
- Kapacitetet e limituara të komunave në sektorin e mjedisit;
- Numri i vogël i inspektorëve të mjedisit në nivel qendror dhe lokal.
- Numri i vogël i zyrtarëve në Institutin e Mbrojtjes së Natyrës;
- Mos certifikimi i zyrtarve (rojeve të natyrës) dhe numri i kufizuar i stafit profesional (zyrtarve mbykqyrës të natyrës) në Drejtoritë për Administrimin e Parqeve Kombëtarë.
- Numri i kufizuar i stafit të rregullt në Drejtorinë për Administrimin e Monumenteve Natyrore me Rëndësi të Veçantë;
- Bordit Këshillëdhënës për Mjedisin ende është jashtë funskionit dhe nuk ka iniciativa për themelimin e tij edhe pse është i paraparë sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Mos funksionalizimi i Ekofondit apo një forndi/programi të veçantë për mjedisin. Të hyrat e inkasuara në emër të mbrojtjes së mjedisit derdhen në Buxhetin e Kosovës por nuk shfrytëzohen për projekte mjedisore.
- Mos zbatimi i plotë i Rregullorës (QRK) Nr. 05/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.
- Pamundësia e integrimit të stafit të MMPH (38 zyrtarë) në komunat e veriut në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara sipas kontratave[30].
- Mungesa e kordinimit të institucioneve relevante për procedimin dhe aprovimit e Planit Hapësinorë për Parkun Kombëtarë Bjeshkët e Nemuna.

[30] Me 11.01.2016 ishte shuar e ashtuquajtura "Mbrojtje civile" në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit të datës 26 mars 2015 dhe Vendimit të Qeverisë. Në MMPH janë angazhuar 38 zyrtarë të shpërndarë në departamente të ndryshme dhe Agjencione të MMPH, për të cilët ministria nuk kishte arritur të ju siguroj zyre në veri të vendit dhe ti integroj ata në procesin e punës. .

- Ndryshimet në strukturën organizative të Qeverisë së Republikës së Kosovës ku Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë fillimisht bashkohet me Ministrinë e Infrastukturës e me pas me atë të Ekonomisë,
- Shuarja e 18 pozitave të nëpunësve civilë të pjesës së ish Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë me Vendim të Qeverisë.

2.3. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit

Në kuadër të kompentenave të kontrollit nga ana e Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave, Natyrës, dhe Planifikimit hapësinorë dhe Ndërtimit sipas detyres zyrtare Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Ministria e Ekonimisë dhe Ambienti gjatë periudhës 2018-2019 janë realizuar: 1,392 aktivitete dhe veprime në bazë të inspektimeve në fushën e mjedisit; 1,141 aktivitete dhe veprime inspektuese me procesverbal në fushën e ujërave; 137 akitivitete dhe veprime mbikqyrëse me procesverval në fushën e natyrës; dhe 841 aktivitete mbikqyrëse me procesverbal në fushën e planifikimit hapësinorë dhe ndërtimeve. Detajet specifike janë prezantuar në tabelën 36.

Tabela 36: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore 2018-2019

Lloji i aktivitetetit inspektuese në fushën e mjedisit	**Numri i aktiviteteve 2018**	**Numri i aktiviteteve 20119**
Vendime	7	63
Gjoba Mandatore	4	58
Rekomandime, vërejtje dhe urdhëresa	245	208
Inicim të procedurave gjyqësore	55	56
Mbikqyrje inspektive me procesverbal	311	385
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e ujërave	**Numri i aktiviteteve 2018**	**Numri i aktiviteteve 2019**
Vendime	88	50
Gjoba Mandatore	-	72
Inicime për procedura kundërvajtëse në gjykata	60	53
Rekomandime, vërejtje, dhe urdhëresa	118	162
Mbikqyrje inspektive me procesverbal	266	272
Lloji i aktivitetetit inspektuese në fushën e natyrës	**Numri i aktiviteteve 2018**	**Numri i aktiviteteve 2019**
Vendime	-	1
Gjoba Mandatore	-	20
Inicime për procedura kundërvajtëse në gjykata	2	2

Rekomandime, vërejtje, urdhëresa dhe informata	32	12
Mbikqyrje inspektive me procesverbal	34	34
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e planifikimit hapësinorë dhe ndërtimit	**Numri i aktiviteteve 2018**	**Numri i aktiviteteve 2019**
Inspektime me procesverbal	186	139
Vendime	36	13
Inicime për procedura gjyqësore	5	5
Rekomandime, vërejtje dhe urdhëresa	159	130
Gjoba mandatore	-	18
Raporte dhe përgjigjje	-	150

Ndërsa në sektorin e mbrojtjes së natyrës në kuadër të kërkesave për fillimin të procedurave kundërvajtës të bazuar në Ligjin e Natyrës dhe Ligjit për Parqe Kombëtare, dhe legjislacionin relevant, gjatë periudhës 2018 – 2019, AMMK në emër të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" dhe Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë "Sharri", ka parashtruar: 486 Kallëzime penale, 36 Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse; dhe 102 Kërkesa për inicimin e kontesteve civile për komensim dëmi.

Përmes inicimit të këtyre 624 procedurave pretendohet zbatimi i ligjit dhe realizimi i dëmit në vlerë totale prej 1,021,297.50 € për institucionin të shkaktuar përmes veprave të kundërligjshme (tabela 37).

Tabela 37: Inicimet e AMMK në Gjykata, Prokurori, dhe Avokaturë Shtetërore

Lloji i aktivitetetit në emër të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë Bjeshkët e Nemuna	**2018**		**2019**	
	Numri i lëndëve	**Shuma e dëmit €**	**Numri i lëndëve**	**Shuma e dëmit €**
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Pejë	67	257,712.50	78	288,687.00
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Gjakovë	3	990.00	-	-
Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Pejë – Divizioni për Kundërvajtje	6	2,387.50	8	1,432.50
